

THESARE

MJET FRYMËZIMI DHE UDHËRRËFYES PËR PASTORËT DHE SHËRBYESIT

numri 3 / vjeshtë 2014



Editorial 2
Gëzim Spahija

Çelësi për Shumëfishim:
Formimi i Një Lëvizjeje
Dinamike Kishëmbjellëse 3
Kurt D. Plagenhoef

Duke i Besuar Perëndisë
Për Fuqizim nga Fryma 9
L. Alton Garrison

Mendime të Vyera
Nga Kapari i Trashëgimisë 16
Mark Wootton

Intervistë me Pastorin
Ervin Kodra 19
Kurt D. Plagenhoef

Duke i Besuar Perëndisë Për
Drejtues sipas Stilit të Jezusit 20
James T. Bradford

Çfarë Lloj Qëndrimi Keni? 26
Marcia Lednický

Ftesa e Altarit: Tërheqja e Rrjetës 30
H. Maurice Lednický

Të Mbjellësh dhe Të Korrësh 34
Glenn Reynolds

Cili Është Qëndrimi dhe Zgjedhja e Duhur 35
Miljard Gosturani

Tema e këtij numri: Duke i besuar Zotit për gjëra të mëdha



Duke i besuar Zotit për gjëra të mëdha...

Jo rrallëherë në jetë na ndodh që të zhgënjehemi nga njerëzit, duke pritur më shumë nga sa ata mund të japin, sepse në të vërtetë ata janë të kufizuar në aftësitë e tyre. Por kurrësi nuk mund të zhgënjehemi nga Perëndia duke e ditur dhe njohur Atë si Zotin e veprave të mëdha.

Ky është besimi që na bën të presim gjithmonë gjëra të mëdha nga Perëndia. Etërit tanë të besimit ia dorëzuan jetën e tyre krejtësisht drejtimit të Zotit. I besuan planit dhe vullnetit të Perëndisë, edhe kur për ta në aspektin njerëzor nuk kishte një arsytim logjik, një zgjidhje apo një dritë të vogël rrugëdaljeje. Zoti është besnik në të vogla dhe në të mëdha. “Nëse besoni në mua”, tha Jezusi, “do të shikoni lavdinë e Perëndisë si dhe do të bëni dyfishin e mrekullive që unë bëra”. “Kush beson në mua do të bëjë edhe ai veprat që bëj unë; madje do të bëjë edhe më të mëdha se këto” (Gjoni 14:12).

Besimi te Perëndia për kryerjen e veprave të mëdha bën që e pamundura të bëhet e mundur. Të vetëm në këtë betejë nuk do të mund të bëjmë asgjë. Por me Perëndinë, mund t’ia dalim. Apostulli Pal e kishte kuptuar sekretin e fitores mbi botën, ndërsa ai tha: “Unë mund të bëj gjithçka nëpërmjet Krishtit që më forcon” (Filipianëve 4:13). Me Perëndinë mundemi. Ne duam të jemi pjesë e vizionit të Tij hyjnor. Ne mund t’ia arrijmë duke kërkuar ndihmën e Tij për shpëtimin e kombit tonë dhe të mbarë Ballkanit. Fjala e Tij na fton: “Vendose fatin tënd tek Zoti. Ki besim tek ai dhe ai

ka për të vepruar” (Psalmet 37:5). “Ki besim tek Zoti me gjithë zemër dhe mos u mbështet në gjykimin tënd; pranoje në të gjitha rrugët e tua, dhe ai do të drejtojë shtigjet e tua” (Fjalët e Urta 3:5-6) sepse “ata që shpresojnë te Zoti fitojnë forca të reja, ngrihen me krahë si shqiponja, vrapojnë pa u lodhur dhe ecin pa u ndalur” (Isaia 40:31).

Ne besojmë se **SOT** është koha e hirit të Zotit, koha e veprave të mëdha. Le të besojmë fuqishëm në të, duke parë me sytë e besimit turmat që të shpëtohen e të mbushin radhët e Mbretërisë së Perëndisë, demonët të dëbohen në emër të Jezui Krishtit, të sëmurët të shërohen, dhe shenja e mrekulli që shoqërojnë predikimin e Fjalës së Zotit. Dhe: “Në qoftë se do të kërkon diçka në emrin tim, unë do ta bëj” (Gjoni 14:14). Zoti i jetës së përjetshme na ka dhënë këtë siguri dhe ne jetojmë dhe shërbejmë me zell e presim realizimin e premtimit të Tij. “Por atij që, sipas fuqisë që vepron në ne, mund të bëjë jashtë mase më tepër nga sa kërkojmë ose mendojmë, atij i qoftë lavdia në kishën në Krishtin Jezus për të gjithë brezat, në jetë të jetëve. Amen” (Efesianëve 3:20-21).



GËZIM SPAHIJA,

Drejtor Ekzekutiv, Këshilli i
Përgjithshëm i Asambleve të
Perëndisë në Shqipëri

THESARE

Numri 3
Vjeshtë 2014

Koordinatorë e projektit: Stephanie Plagenhoef
Përkthyes: Fabian Tozharaku
Redaktues: Skënder Hoxha
Grafika kompjuterike: Lindita Sqapi

Botuar nga:
Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë
të Shqipërisë

Në bashkëpunim me:
Life Publishers International

Adresa: K.P. 119 / Kutia 2 / Tirana, Albania
Tel: (+355) 48-302611
Email: KTU@icc-al.org



Artikujt e zgjedhur dhe grafika përshtatur nga revista Enrichment - ©Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë, ShBA. Përdorur me leje.

©Life Publishers International. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Celësi për Shumëfishim:

*Formimi i
një Lëvizjeje
Dinamike*

KISHËMBJELLJEJE

Nga: KURT D. PLAGENHOEF

PJESA IV

NJË PLAN STRATEGJIK PËR KRIJIMIN E NJË LËVIZJEJE KISHËMBJELLËSE BRENDË ASAMBLEVE TË PERËNDISË NË SHOIPËRI

P*jesa e parë e kësaj serie solli propozimin që strategjia e Dhiatës së Re për përhapjen e ungjillit dhe vendosjen e mbretërisë së Perëndisë mbi tokë është përmes kishëmbjelljes. Në të u diskutua nevoja për të zhvilluar një lëvizje kishëmbjellëse e cila të ishte e bazuar në Bibël si dhe të ishte e shëndetshme nga pikëpamja e misiologjisë për kishat e Asambleve të Perëndisë në Shqipëri. Në pjesën e dytë u eksplorua një misiologji e Dhiatës së Re për kishëmbjelljen në Veprat e Apostujve. Në pjesën e tretë u shqyrtuan parimet, strategjitë dhe praktikat e vërtetuara të kishëmbjelljes. Tek pjesa e katërt do të paraqitet një plan strategjik për krijimin e një lëvizjeje kishëmbjellëse brenda Asambleve të Perëndisë në Shqipëri.*

Unë jam i bindur që Zoti po na drejton për të themeluar një lëvizje vendore kishëmbjellëse brenda Asambleve të Perëndisë në Shqipëri. Zoti ka qenë shumë i hirshëm duke ngritur në Shqipëri një trup ungjillorësh prej rreth 20,000 besimtarësh që prej vitit 1991, duke përfshirë këtu rreth 1,000 besimtarë në bashkësitë tona të Asambleve të Perëndisë. Dhe kjo, në kontekstin e një vendi me sfond historik mysliman, është me të vërtetë vepra e Zotit. Me sa di unë, Shqipëria është kombi mysliman më i hapur në botë ndaj ungjillit. Kemi marrë një sërë fjalësh profetike që Perëndia ka një plan të veçantë për Shqipërinë, jo vetëm për të arritur shqiptarët që ndodhen në Ballkan, por gjithashtu për të pasur një ndikim domethënës në Turqi dhe në botën myslimane. Me qëllim që të përmbushet kjo thirrje dhe ky vizion i Perëndisë, është i nevojshëm themelimi i një lëvizjeje të fuqishme kishëmbjellëse.

Aktualisht kemi dhjetë kisha të themeluara dhe nëntë kishëmbjellje në lëvizjen tonë. Vizioni ynë është ta

dyfishojmë bashkësinë tonë brenda pesë viteve. Me qëllim që ta përmbushim këtë objektiv, është e nevojshme të kemi një strategji të qartë për një lëvizje vendore kishëmbjellëse, e cila do të ndryshojë kursin e historisë së mbretërisë në vendet e Ballkanit dhe përtej.

Dejvid Gerizën (David Garrison) ka studiuar lëvizjet kishëmbjellëse, të cilat ai i përkufizoi si “një rritje e shpejtë dhe shumëfishuese e kishave vendore kishëmbjellëse brenda një grupi të caktuar njerëzish ose brenda një segmenti të popullsisë”.¹ Kjo është ajo për të cilën kemi nevojë në Shqipëri dhe në Ballkan. Me qëllim që të arrijmë më shumë njerëz të humbur, të mbjellim më shumë kisha, dhe të vëmë më shumë pastorë shqiptarë në krye të shërbesave, na duhet që të kemi një plan strategjik për kishëmbjelljen. Përveç implementimit të parimeve të cilat tashmë i kemi diskutuar, le të shohim disa hapa praktike dhe një strategji konkrete të cilat janë të nevojshme që kjo gjë të bëhet realitet.

IDENTIFIKONI OBJEKTIVAT PARËSORE

Vizioni ynë që prej vitit 2011 ka qenë për të filluar një lëvizje kishëmbjellëse duke themeluar pesë kisha të reja në Shqipëri dhe më pas duke e zgjeruar atë në të gjithë Shqipërinë dhe në rajonin ballkanik të Evropës juglindore. Ky objektiv pothuajse është arritur. Këto më poshtë janë disa nga kishëmbjelljet që janë aktualisht në proces e sipër:

Durrës: Durrësi është qyteti i dytë më i madh në Shqipëri me 450.000 banorë, 18 kisha ungjillore, duke përfshirë një kishë të Asambleve të Perëndisë. Asambletë e Perëndisë gjithashtu kanë edhe një kishë pranë Durrësit, në **Shkallnur**. AP Durrës është trupi kishëmbjellës kryesor i lëvizjes sonë, e cila është duke mbjellë disa kisha të ndryshme në rajonin e Durrësit. Në vitin 1996 një kishëmbjellje filloi në **Sukth**, e cila sot ka rreth 55 besimtarë. Edhe pse AP Sukth qëndron nën mbikëqyrjen e AP Durrës, qëllimi është që kjo punë, në të ardhmen e afërt, të kthehet në një kishë vetë-qeverisëse, vetë-mbështetëse dhe vetë-reklamuese. AP Sukth ka një pikë predikimi në fshat **Sallmonë**. Gjithashtu AP Durrës filloi një kishëmbjellje në **Fllakë** në vitin 1998, e cila ka pothuajse të njëjtin numër besimtarësh si Sukthi dhe po rritet drejt pavarësisë. Fllaka ka një vend predikimi në **Porto Romano**. Gjithashtu ekziston një kishëmbjellje

në **Lagjen 6**, pranë Sukthit, e cila ka vetëm tre vjet që ka filluar, por ka rreth 20 besimtarë. Një kishëmbjellje e re, e udhëhequr nga misionarë italianë të Asambleve të Perëndisë, u nis në pranverë të vitit 2014 në **qendrën e Durrësit**, një zonë që nuk ka asnjë kishë.

Bathore: Me mijëra njerëz nga veriu i Shqipërisë kanë vërshuar në këtë zonë duke kërkuar punësim, arsimim dhe një jetë më të mirë pranë kryeqytetit. Shumë prej tyre nuk kanë dëgjuar kurrë rreth jetës së përditshme që ofrohet përmes Krishtit. **AP Institut** nisi një kishëmbjellje në qershor të vitit 2013 për të arritur këtë popullsi, dhe ka pasur një fillim shumë të fortë. Rreth 15 të rinj dhe të rritur si edhe shumë fëmijë kanë njohur Krishtin nëpërmjet kësaj shërbesë. Më shumë se 150 njerëz po arrihen përmes shërbesave javore. Skuadra shumëkombëshe e shërbesës, të cilën Perëndia e ka

mbledhur bashkë në një thirrje, është shumë unike dhe përfshin shqiptarë, dy brazilianë, një rumune dhe një finlandez. Dëshira jonë është që këto lloj skuadrash shumëkombëshe që mbjellin kisha t'i shohim të shumëfishohen, duke qenë se larmia që ato kanë dhe përzierja e dhuntive dhe aftësive të tyre janë shumë efikase së bashku, kur ekziston një udhëheqësi e mirë. Një grup shtëpie në **Kasallë**, që është një tjetër punë ungjillizuese nga AP Institut, u nis në fillim të vitit 2014. Kjo është kishëmbjellja e parë në një zonë me 20.000 banorë.

Rruga Ura, Tiranë: Kjo kishëmbjellje filloi para disa vitesh si një ungjillizim nga Kisha “Lajmi i Mirë” në Tiranë në bashkëpunim me FIDA-n. Kisha ka një grup të vogël besimtarësh dhe po fokusohet tek shërbesat e fëmijëve, të rinjve dhe të grave. Kjo është një zonë në Tiranë e cila është në rritje dhe përgjithësisht e paarritur. Tirana është një qytet me



përafërsisht një milion banorë dhe me rreth 70 kisha ungjillore, duke përfshirë tri kisha të AP-së. Me qëllim për të arritur 10% të popullsisë së Tiranës (100.000 njerëz), na nevojiten 1.000 kisha me nga 100 njerëz. Është e nevojshme të mbillen shumë më tepër kisha në zemër të Shqipërisë!

Kryekuq: Kisha në këtë fshat është duke u mbjellë nga kisha "Uji i Gjallë" në Divjakë. Aty është një grup besimtarësh që takohen në shtëpinë e njërit prej anëtarëve të "Ujit të Gjallë". Strategjia e kishave që mbliiden në shtëpi është një model i mirë për t'u synuar për Shqipërinë rurale.

Shkup, Maqedoni: Asambleja e Perëndisë, që prej vitit 2005, ka dërguar skuadra lutjeje dhe ungjillizimi në Maqedoni. Në këtë vend me dy milion banorë, janë vetëm rreth 50 kisha ungjillore maqedonase dhe 2.000 besimtarë. Partneri ynë kombëtar, lëvizja e Kishës Ungjillore të Maqedonisë, ka rreth 35 kisha dhe 1.000 besimtarë. Në mesin e popullatës shqiptare që luhatet në shifrat nga 500.000 deri në 700.000 banorë, ekzistojnë vetëm një grusht besimtarësh që dihen dhe asnjë kishë shqiptare. Në shtator të vitit 2009, dërguam në Shkup misionarin tonë të parë nga Asambleja e Perëndisë. Puna ka shumë sfida. Pas pesë vitesh shërbesë, me qindra e kanë dëgjuar ungjillin për herë të parë, dy vetë kanë pranuar Krishtin, dhe shumë të tjerë janë shumë afër bërjes së një përkushtimi publik ndaj Krishtit. Përqindja e myslimanëve në Shkup që e praktikojnë fenë e tyre është shumë më e lartë sesa në Shqipëri. Zoti dha një fjalë profetike para dy vitesh duke thënë se ai po hapte një pus në Shkup dhe që shumë njerëz do të vinin të pinin ujin e gjallë. Le të lutemi dhe të besojmë që fjala e Zotit do të përmbushet. Aktualisht kemi dy misionarë shqiptarë të Asamblesë së Perëndisë në Shkup. Ata kanë shumë nevojë për lutjet tona dhe gjithashtu për më shumë bashkëpunëtorë. Ndoshta Perëndia do t'ju thërrasë juve në këtë punë strategjike.

I jemi mirënjohës Perëndisë për të gjitha iniciativat e kishëmbjelljes që po ndërmerren. Në të njëjtën kohë, jemi të vetëdijshëm që ka shumë zona në Shqipëri dhe në Ballkan që vazhdojnë të jenë pa dëshmitarë të ungjillit të cilat kanë nevojë për një kishë. Duke kërkuar të identifikojmë zonat më pak të arritura dhe ato të paarritura si objektivat parësore për kishëmbjellje, duke përfshirë Shqipërinë e Veriut, Maqedoninë Perëndimore, Kosovën dhe jugun e Malit të Zi, si drejtues dhe pastorë, ne kemi piketuar disa qytete për kishëmbjellje të ardhshme.

Shqipëria e Veriut: Tropoja është një zonë kyçe në veriun e Shqipërisë, e cila si rreth ka një popullsi prej afërsisht 30.000 banorësh. Veriu i Shqipërisë, bashkë me malet e tij të thepisura, komunitetet e izoluara dhe me papunësinë dhe varfërinë e lartë, është zona më e paarritur e Shqipërisë. Ekzistojnë disa kisha ungjillore dhe disa misionarë që po punojnë në këtë rajon. Kisha jonë e vetme e Asamblesë së Perëndisë në veri të Shqipërisë është "Kisha e Mbretit" në **Fushë-Arrëz**. Gjithashtu kemi investuar në trajnimin e drejtuesve në Shkodër, që është qyteti kryesor i veriut, përmes një filiali të zgjeruar të KTU-së. Shumë njerëz nga Tropoja kanë ardhur në Tiranë. Një numër tropojanësh janë bërë besimtarë në kishën tonë në Institut. Do të donim të shihnim disa prej këtyre besimtarëve, qoftë një çift ose një skuadër, që ta çonin ungjillin në vendin e tyre të lindjes. Rrethi fqinj, **Hasi**, me një popullsi prej rreth 17.000 banorësh është gjithashtu një zonë për t'u pikasur. **Bulqiza** është një qytet i paarritur në pjesën qendrore të Shqipërisë së Veriut me rreth 11.000 banorë. Një nga pastorët tanë ka një lidhje familjare atje dhe dëshiron të fillojë një kishë në atë zonë.

"Qyteti Studenti", Universiteti i Tiranës: Kjo është një zonë e Tiranës në të cilën jetojnë mbi 14.000 studentë nga e gjithë Shqipëria. Përgjithësisht, studentët janë të hapur ndaj ungjillit. Ata janë një objektiv strategjik për shkak se shumë prej atyre që bëhen besimtarë do ta marrin ungjillin e do ta çojnë në qytetet apo fshatrat e tyre. Disa prej tyre do të kthehen në udhëheqës në fushat e profesionit të tyre dhe do të bëjnë pjesë ndër njerëzit më me influencë aty. Asambleja Protestante Ndërkombëtare (AP) në Tiranë, dëshiron të mbjellë një kishë në këtë pjesë të qytetit. Besimtarët nga kishat tona të Asamblesë së Perëndisë në Tiranë dhe studentët nga kolegji ynë biblik i Asamblesë së Perëndisë, Kolegji Teologjik Ungjillor (KTU), mund të ndihmojnë në këtë përpjekje.

Mitrovicë, Kosovë: Ky është një qytet me më shumë se 100.000 banorë i cili nuk kishte asnjë dëshmi ungjillore deri kur filloi kishëmbjellja jonë më 1999, menjëherë pas luftës në Kosovë. Për shkak të ndarjes së vazhdueshme të qytetit dhe të armiqësisë midis shqiptarëve dhe serbëve, Mitrovica është një vend shumë i vështirë që ta paraqesësh Krishtin dhe të mos shihesh me sy armiqësor. Por ungjilli i vërtetë po i rrëzon barrierat. Kisha, në periudhën e para dy viteve, po arrinte rreth 60 të rinj dhe 150 fëmijë çdo javë. Ishin rreth 15 besimtarë. Puna e kishës u pezullua përkohësisht, por tani po rifillon në drejtimin e një misionari të ri rumun që po punon në partneritet me misionarë amerikanë të Asambleve të Perëndisë. Asambletë e Perëndisë në Shqipëri po e mbështetin këtë punë përmes lutjeve dhe skuadrave. Parashikojmë të dërgojmë misionarë shqiptarë sipas thirrjes dhe drejtimit të Perëndisë. Lutuni për më shumë punëtorë dhe për atë që ju mund të bëni për të ndihmuar me këtë fushë nismëtare.

Ulqin, Mali i Zi: Ky është një qytet me shumicë shqiptare në jug të Malit të Zi, ku kemi qenë duke dërguar skuadra lutjeje dhe ungjillizimi për një numër vitesh. Jemi lidhur atje me një misionare kosovare e cila po punon me një çift besimtarësh nga Ulqini. Ndërsa jemi lutur për punëtorë, Perëndia i ka folur të paktën dy çifteve, të cilët i njohim, rreth idesë për të shkuar në Malin e Zi në të ardhmen. Gjithashtu dëshirojmë të lidhemi në partneritet me kishën në Shkodër e cila ka dërguar skuadra ungjillizimi përtej kufirit gjatë viteve të kaluara. Kisha në Shkodër, për shkak të afërsisë së tyre dhe lidhjeve me Malin e Zi, është e pozicionuar në mënyrë strategjike për këtë punë. Si vendi më i paarritur në Evropë, le të lutemi që kisha e Perëndisë të themelohet në mesin e shqiptarëve në Malin e Zi.



IDENTIFIKONI PERSONELIN E DUHUR

Për ndërtimin e një lëvizjeje kishëmbjellëse është themelore pasja e njerëzve të duhur në pozicionet e duhura.

Jam dakord me Barnan që “thirrja, karakteri dhe kompetencat janë të rëndësishme për udhëheqjen efikase”.² Në kërkimin tonë për kandidatë kishëmbjellës, po shohim për këto tri gjëra: 1) një thirrje plot pasion ndaj kishëmbjelljes në mesin e njerëzve të paarritur; 2) karakter dhe integritet të perëndishëm; dhe 3) kompetenca të vërtetuara përmes shërbesës së frytshme dhe besnike në kishën vendore.

Të kesh njerëzit e duhur në vendin e duhur është diçka shumë e rëndësishme. Xhim Kollins (Jim Collins) i vë theksin idesë që si fillim duhet të hipim njerëzit e duhur në autobus, të zbresim njerëzit e gabuar nga autobusi, dhe më pas të vendosim se ku do të shkojmë me autobus.³ Ai i vë theksin rëndësisë për ta filluar mendimin me pyetjen “kush” në vend që ta fillojmë me pyetjen “çfarë”. Nëse pajisemi me njerëzit e duhur, me ata më të mirët, atëherë do të ketë më shumë gjasa që të kemi sukses pavarësisht se në cilin drejtim jemi nisur. Ne e dimë se për ku jemi nisur – drejt një lëvizjeje kishëmbjellëse vendore në mesin e atyre që nuk janë arritur.

Njerëzit janë kapitali ynë më i madh, dhe njerëzit e duhur do të na ndihmojnë të themelojmë llojin e duhur të lëvizjes. Tani po hasemi me një numër të madh të të rinjve besimtarë dhe të drejtuesve të rinj. Shumica e njerëzve tanë janë brezi i parë i ndjekësve të Krishtit në Shqipëri, pjesa më e madhe e të cilëve janë besimtarët e vetëm në familjet e tyre. Kjo gjë nënvizon nevojën për të pasur një trajnim të mirë. KTU, shkolla jonë dy-vjeçare, po ofron trajnim bazë dhe solid të Biblës, teologjisë dhe shërbesës. Një program praktikant i vitit të tretë në kishëmbjellje dhe mision ofron studime të specializuara dhe trajnim ‘në vendin e punës’. Kandidatët për kishëmbjellje duhet të përfundojnë shkollë biblike.

Duke pasur parasysh moshën e re dhe përvojën e kufizuar në shërbesë të shumë prej të diplomuarve nga shkollat biblike, ne kemi si qëllim që t’i caktojmë një mentor pastoral të gjithë kandidatëve për kishëmbjellje. Mentorët do të ndihmojnë duke mbikëqyrur dhe duke e ndihmuar kishëmbjellësin për të paktën tre vjet. Unë besoj që ky do të jetë një faktor vendimtar për të korrur sukses. Shumë drejtues shqiptarë në kishën ungjillore nuk kanë një baba frymëror ose një mentor i cili mund t’i ndihmojë ata në ecjen e tyre me Zotin dhe me shërbesën. Një numër tepër i madh i tyre janë vetëm, gjë që i bën ata më të dobët dhe më të cënueshëm ndaj tundimeve dhe sulmeve të armikut. Mentorët mund të sjellin ndryshimin në suksesin apo dështimin e të rinjve drejtues.

Ekzistojnë faktorë organizativë si edhe faktorë frymërorë të cilët duhet të merren parasysh kur zgjedhim personelin e duhur. Nuk po kërkojmë thjesht që të zgjedhim njerëzit që na duken neve si më të mirët, por të identifikojmë ata të cilët po ngre Zoti. Ashtu si agjëroi dhe u lut kisha në Antioki përpara se të dërgonin Palin dhe Barnabën (Vep 13:2), edhe ne gjithashtu agjërojmë dhe lutemi për këto vendime. E dimë që kjo është punë frymërore të cilën vetëm Perëndia mund ta bëjë. “Në qoftë se Zoti nuk ndërton shtëpinë, më kot lodhen ndërtuesit” (Psa 127:1). Ne varemi plotësisht nga Ai. Rexhi Meknill (Reggie McNeal), duke iu drejtuar zhvendosjes nga planifikimi tek përgatitja për kishëmbjellje, tha: “Bibla i bën jehonë një teme të përsëritur: Perëndia dëshiron që populli i tij të lutet dhe të përgatitet për ndërhyrjen e tij”.⁴ Dhe kur ne lutemi, Ai ndërhyr!

Principatat dhe pushtetet demonike kanë sunduar në këto zona për shekuj me radhë, dhe ato nuk do ta lëshojnë lehtësisht territorin e tyre. Në Shqipëri kemi mësuar që shumë male frymërore nuk kanë për të

lëvizur dhe shumë fortesa frymërore nuk kanë për t'u rrëzuar pa e shtuar lutjen dhe agjërimin. Perëndia e vajos dhe e nderon agjërimin duke i dhënë intensitet më të madh ndërmjetësimit tonë, gjë e cila rezulton në një manifestim më të madh të fuqisë së Perëndisë. Ndërsa përzgjedhim personelin dhe nisim udhëtimin në çdo kishëmbjellje, ne caktojmë kohë së bashku për lutje dhe agjërim për të përgatitur territorin frymëror. I besojmë Jezusit se do të thërrasë dhe do të ngrejë kishëmbjellës të cilët do të jenë të barabartë për detyrën.

Siç u përmend në pjesën rreth identifikimit të objektivave parësore, kemi identifikuar tashmë drejtues për shumë nga punët e reja, por ata kanë nevojë për skuadra mbështetëse. Skuadrat kishëmbjellëse janë më efikase sesa individët apo çiftet që punojnë vetëm, dhe këtë fakt po e implementojmë si pjesë të strategjisë sonë. Në mënyrë ideale, çdo kishëmbjellje ka nevojë për një pastor shqiptar, për dikë që është nga ai qytet dhe tashmë e ka një rrjet familjarësh dhe miqsh të cilët mund të sigurojnë mbështetje dhe një themel për punën. Kishëmbjellësi mund të jetë ose të mos jetë pastori afatgjatë që do të vazhdojë të kujdeset për tufën. Në përgjithësi, ne po kërkojmë kandidatë për kishëmbjellje nga mesi i të diplomuarve të KTU-së. KTU-ja tërheq studentë nga kishat e Asamblesë së Perëndisë dhe nga kishat e tjera në Shqipëri dhe në Kosovë, dhe siguron një depozitë të mirë e në rritje të punëtorëve për kishën që po zgjerohet. Ne po e ndajmë vazhdimisht vizionin për kishëmbjelljen me studentët dhe po i besojmë Zotit që të thërrasë ata që ka zgjedhur.

SIGURONI FONDET E NEVOJSHME

Me qëllim që çdo vizion të ketë sukses, ai duhet të jetë i financuar. Asambleja e Perëndisë, si një lëvizje me vendndodhje në një shtet në zhvillim, po hedh hapa të mëdha drejt pavarësisë së saj ekonomike. Ky është standardi biblik dhe objektivi ynë i qartë. Shumica e kishave ungjillore në Shqipëri, duke përfshirë edhe ato të bashkësisë sonë të Asambleve të Perëndisë, nuk janë akoma plotësisht të pavarura ekonomikisht dhe mbështeten nga jashtë për një pjesë të suportit financiar. Ky është një faktor i rëndësishëm dhe një konsideratë e rëndësishme për formimin e një lëvizjeje vendore kishëmbjellëse. Si misionarë, ne duhet të gjejmë balancën e duhur ndërkohë që kërkojmë të jemi partnerë fuqizues, por të mos jemi sundimtarë patriarkalë. Ne duhet ta sfidojmë Kishën në Shqipëri që të ushtrojë besim të madh dhe

të bëjë sakrifica të rëndësishme për të bërë gjithçka mundet për të përhapur punën e mbretërisë dhe për të marrë përsipër përgjegjësinë e punës.

Melvin Hoxhs (Hodges) ofron mendime të vyera rreth natyrës së pavarësisë ekonomike të kishës vendore.

Përse ndodh që pas dhjetë, pesëmbëdhjetë apo njëzet vitesh të përpjekjeve misionare në një zonë të caktuar, ne duhet akoma që t'u bëjmë thirrje kishave nga vijmë për fonde apo punëtorë shtesë? Ja ku qëndron çelësi i problemit: Si misionarë, shumë shpesh ne i kemi stërvitur besimtarët për të qenë të varur në vend që të jenë të përgjegjshëm. Njësia e vërtetë matëse e suksesit nuk është se çfarë arrijnë misionarët ndërkohë që janë në fushën e misionit, por puna që vazhdon të qëndrojë edhe pasi ata të jenë larguar.⁵

Këto, për mua si misionar, janë fjalë goditëse që e prekin zemrën time, m'i trazojnë mendimet dhe më çojnë në një shqyrtim të vetvetes. Unë dëshiroj të lë pas një punë në Shqipëri e cila jo vetëm të qëndrojë pasi të jem larguar, por gjithashtu të vazhdojë të rritet dhe të shumëfishohet. Ky duhet të jetë objektivi i çdo misionari. Duhet të investojmë në natyrën e vërtetë të mbretërisë, e cila në thelb nuk është financiare, por frymërore.

Ne nxisim çdo besimtar dhe bashkësi vendore që të japë në mënyrë sakrifikuese. Ralf Mor thotë: "Burimi *ideal* për të financuar një kishë të re është bashkësia mëmë, anëtarët e së cilës përqafojnë idenë e shtrirjes së ungjillizimit përmes kishëmbjelljes".⁶ Ne akoma nuk kemi shumë bashkësi mëmë që kanë edhe fuqinë e personelit, edhe atë financiare, për të mbjellë kisha në mënyrë të pavarur, por kemi krijuar një fond për kishëmbjellje të administruar nga Këshilli i Përgjithshëm për të ndihmuar kishat vendore në përpjekjet e tyre kishëmbjellëse. Ne punojmë si një mision besimi, dhe i besojmë Zotit që të sigurojë përmes përpjekjeve tona të përbashkëta.

Me ndihmën e Perëndisë, Këshilli i Përgjithshëm mund të ndihmojë asambletë vendase duke siguruar fonde mbështetëse për qiranë, pajisjet dhe për shpenzime të tjera fillestare, në vend që t'u japë mbështetje personale kishëmbjellësve. Megjithëse e kuptojmë se kjo është një sakrificë, kishëmbjellësi duhet të ushtrojë besimin e tij që prej fillimit. Kur të vijë koha për shpenzime më të mëdha kapitale si blerja e tokës dhe ndërtimi i ambienteve të përhershme, Këshilli i Përgjithshëm, misionarët e huaj dhe pastorët vendorë mund të hyjnë në partneritet së bashku. Kishëmbjellësi duhet të fitojë të humburit dhe t'u mësojë besimtarëve të rinj që të japin të dhjetat dhe ofertat me qëllimin për t'u bërë një kishë e pavarur ekonomikisht.

PËRMBYLLJA

Në këto artikuj, jam munduar të paraqes një plan strategjik, të bazuar në Bibël dhe të shëndetshëm nga pikëpamja misiologjike, për themelimin e një lëvizjeje vendase kishëmbjellëse në Shqipëri. Pasi kemi eksploruar rritjen dhe shumimin e kishës në librin e Veprave të Apostujve si edhe parimet biblike për kishëmbjelljen, unë ndihem i sigurt që jemi duke shkuar në drejtimin e duhur. Zbatimi i këtij plani strategjik do të kërkojë besim dhe sakrificë nga të gjithë ne. Si drejtues, duhet të ushtrojmë urtësinë edhe disiplinën për të mos devijuar nga parimet vendore të Dhiatës së Re për kishëmbjelljen. Është shumë kollaj që ta gjytojme në mënyrë të pavetëdijshme kishën e re të cilën e duam, duke u bërë një mbështetje për këmbët të cilat duhet të mësojnë të ecin vetë që të bëhen të forta.

Kjo lëvizje kishëmbjellëse do të vërë në provë karakterin, thirrjen dhe përkushtimin tonë për të arritur popullin shqiptar dhe të tjerët më tej. Do të jetë një sfidë se sa të gatshëm jemi ne për të dhënë, sa larg jemi të gatshëm të shkojmë dhe me sa sakrificë jemi të gatshëm që t'u shërbejmë të humburve dhe atyre që nuk janë arritur për hir të kauzës së Krishtit. Përgjatë viteve të komunizmit, njerëzit mësuuan të punojnë shumë dhe të jetojnë me pak. Megjithatë, ky brez po venitet, dhe brezi i ri pret që të marrë më shumë me shumë më pak përpjekje. Mbretëria e Perëndisë kërkon gjithçka tonën. Jezusi foli për shërbëtorin që hyri në shtëpi pas një dite të lodhshme pune në arë. Edhe pse ishte i lodhur dhe i uritur, në vend që të ulej të hante bashkë me zotërinë e tij, ai i shërbeu më parë zotërisë së tij përpara se të merrte ushqim për vete. Kjo ishte detyra e tij si një shërbëtor. Jezusi tha: "Kështu edhe ju, kur të keni bërë të gjitha ato që ju urdhërohen, thoni: 'Jemi shërbëtorë të padobishëm. Ne kemi bërë atë që kishim detyrë të bënim'" (Luka 17:10).

Ndërsa japim jetët tona, duke kërkuar vetëm që të kënaqim Zotin, ai do të na përdorë për të sjellë të korrat. Ndërsa agjërojmë, lutemi, predikojmë me guxim ungjillin aty ku Krishti nuk njihet, dhe ndërsa durojmë vuajtje dhe vështirësi, Zoti do ta vajosë fjalën e tij dhe do të ndërtojë kishën e tij. Ne kemi një vizion të qartë, një bërthamë besimtarësh dhe drejtuesish të përkushtuar si dhe burimet për t'u nisur në këtë udhëtim më të thellë të mbjelljes së kishave

të cilat do ta riprodhojnë vetveten. Unë besoj se kjo gjë do të kërkojë një përkushtim afatgjatë nga të gjithë ne, si shërbëtarë vendorë kishash, si drejtues kombëtarë kishash dhe si partnerë misionarë. Unë dhe drejtues të tjerë kombëtarë kishash jemi të gatshëm që ta bëjmë këtë përkushtim. A do të bashkoheni edhe ju me ne?

Untër dhe Koh (Winter and Koch) kanë thënë: "Të shohë që Krishti adhurohet dhe ndiqet nga çdo popull – kjo është detyra esenciale e misionarit".⁷ Unë po e përkushtoj jetën time për të parë që Krishti njihet dhe lavdërohet në mesin e popullit shqiptar. Pas dy dekadash shërbim në Shqipëri dhe pasi kam parë atë që ka bërë Perëndia, unë shoh drejt të ardhmes duke pritur me padurim atë që Perëndia do të vazhdojë të bëjë. Unë besoj se, më shumë se çdo gjë tjetër, një lëvizje vendore e fortë kishëmbjellëse do të sigurojë që Krishti po adhurohet në mesin e shqiptarëve. Unë do të isha i nderuar të isha pjesë e kësaj trashëgimie. Shpresoj të jem gjallë që të shoh ditën kur bashkësia e Asambleve të Perëndisë të jetë shumëfishuar në të gjithë Ballkanin dhe të jetë zhvilluar në një lëvizje të Frymës e cila do të mirëpresë me dhjetëra, madje me qindra mijëra shqiptarë në mbretërinë e tij të përjetshme.

¹ Garrison, Davis. "Church Planting Movements." 1999:8.; <http://www.churchplantingmovements.com/images/stories/CPM_Profiles/cpm_booklet_standard_english.pdf>. (rigjetur në 2 Dhjetor 2010).

² Blackaby, Henry dhe Richard. *Spiritual Leadership: Moving People on to God's Agenda*. Nashville, Tenn.: Broadman & Homan Publishers, 2001:19.

³ Collins, James C. *Good to Great: Why Some Companies Make the Leap—and Others Don't*. New York, N.Y.: Harper Business, 2001:41.

⁴ McNeal, Reggie. *The Present-Future: Six Tough Questions for the Church*. San Francisco, Calif.: Jossey-Bass, 2003:93.

⁵ Hodges, Melvin. *The Indigenous Church*. Springfield, MO: Gospel Publishing House, 1976:27, 29, 30.

⁶ Moore, Ralph. *Starting a New Church: The Planter's Guide to Success*. Ventura, Calif.: Regal Books, 2002:52.

⁷ Winter, Ralph D. dhe Bruce A. Koch. "Finishing the Task: The Unreached Peoples Challenge." *International Journal of Frontier Missions* 16:2 (Verë 1999): 72.



KURT D. PLAGENHOEF, M.A.

Zv.Drejtor Ekzekutiv KPAPSH dhe President i Kolegjit Teologjik Ungjillor, misionar në Shqipëri prej 19 vitesh.

DUKE I BESUAR PERËNDISË

për

FUQIZIM

nga

FRYMA

Nga: L. Alton Garrison

*A janë duke e braktisur besimtarët
në kishë fuqizimin nga Fryma për
shkak se ne nuk po u japim atyre
aksesin tek ky fuqizim?*

N

e kërkojmë përvoja të jashtëzakonshme.

Reflektojmë pasionin tonën gjithçka për një jetë

përtej të përditshmes duke filluar nga kërkimi ynë

për sukses në karrierë deri tek prioritetet tona

për argëtim dhe madje deri në atë se çfarë presim

në adhurimin tonë të përbashkët.

Ky brez duket i preokupuar me fenomene të cilat janë jashtë normales. Duke filluar që nga filmat, deri tek librat dhe vizatimet komike mbi të cilat regjisorët i kanë bazuar këta filma, superheronjtë dhe personazhe të tjerë përtej sferës së natyrshme monopolizojnë vëmendjen e miliona njerëzve. Përse? Unë besoj se ata kuptojnë një të vërtetë themelore të jetës – që ekziston një realitet përtej botës materiale dhe që në këtë univers po vepron një fuqi më e madhe.

Mendoni se sa e privilegjuar është kisha. Si ndjekësit Krishtit, ne mund të përfetojmë një prani dhe fuqi shumë të vërtetë, që është përtej kapacitetit njerëzor. Mund të jemi të fuqizuar nga Fryma.

Qëllimi parësor i fuqizimit nga Fryma është të kryejë misionin transformues të Perëndisë në mesin e të humburve. Me sfidat me të cilat përballet sot kisha, përpjekja për të ndikuar me ndryshim në jetët e njerëzve duke përdorur thjesht zgjuarsinë tonë, intelektin dhe përpjekjen tonë njerëzore është e kotë.

Perëndia nuk na ka braktisur në atë strehë të pafrytshme. Kur ne kapemi pas fuqisë së Frymës, Ai na pajis plotësisht dhe na jep guxim për ta ballafaquar botën tonë të humbur me shpresën e ungjillit.

PENTEKOSTALË ME KOHË TË PJESSHME

Për fat të keq, duket që besimtarët në shumë qoshe të kishës ose janë duke e braktisur fuqizimin nga Fryma ose madje kanë dështuar edhe që të kenë të drejtën për ta pasur këtë fuqizim. Kam frikë se edhe nëse Fryma e Shenjtë do të hiqej plotësisht nga një kishë, shumë elemente të punës së asaj kishë do të vazhdonin sikur të mos kishte ndodhur asgjë.

Çfarë shpërfytyrimi i asaj që çdo kishë duhej të ishte. A mund të jetë kjo gjithashtu e vërtetë edhe për jetët tona personale? A janë shumica prej nesh në fushën tonë të thirrjes për shërbesë duke i bërë aktivitetet e krishtera automatikisht ditë pas dite pa pasur asnjë prekje nga Perëndia?

Pa atë prekje, të shkaktuar në mënyrë shumë të fuqishme nëpërmjet mbushjes dhe ndikimit të Frymës së Shenjtë, besimtarët pengojnë pjesëmarrjen e tyre efikase në Urdhërimin e Madh. A. W. Tozer ofroi këtë vëzhgim, në përshtypje të parë kontradiktor ndaj ndjekësit të Krishtit i cili është i shqetësuar për të qenë i dobishëm në Mbretëri: "Nocioni popullor që, detyrimi i parë i kishës është të përhapë ungjillin deri në pjesët më të largëta të tokës, është i rremë. *Detyrimi i parë i saj është të jetë e denjë nga ana frymërore për ta*

*përhapur atë. Zoti ynë tha: "Shkoni", por Ai gjithashtu tha: "Prisni", dhe pritja duhet të vinte përpara shkuarjes. Nëse dishepujt do të ishin dërguar si misionarë përpara Ditës së Rrëshajëve, atëherë do të kishte ndodhur një gjë më frymërore dërmuese."*¹

Unë besoj që kishat të cilat e kanë holluar deklaratën fillestare të misionit të Zotit tonë, meritojnë paralajmërimin që iu dha profetit Jeremia: "Sepse populli im ka kryer dy të këqija; më ka braktisur mua, burimin e ujit të gjallë, për të hapur sterna, sterna të prishura, që nuk e mbajnë ujin" (2:13). Kisha të tilla kanë një formë perëndishmërie, por prej kësaj e mohojnë fuqinë në marrjen prej tyre me gjysmë zemre të udhëheqjes dhe fuqisë së Frymës. Këto kisha e kanë shkëputur veten e tyre nga burimi i ujit të gjallë dhe rrjedhimisht nuk kanë me se t'i mbushin sternat e tyre. Ajo që mbetet është një guaskë bosh, pothuajse një lëvore boshe teologjike.

Këto kisha janë pentekostale ndonjëherë – kur është e leverdishme, kur ka siguri, kur është korrekte nga ana sociale. Besimtarët e tillë janë pentekostalë me kohë të pjesshme. Ata e kanë këmbyer shenjtërinë me një publicitet të ekzagjeruar; e kanë harruar drejtësinë në ndjekjen e tyre të ritualeve; kanë zotëruar formën e fesë ndërkohë që sakrifikojnë forcën e Frymës.

Këto kisha janë pentekostale ndonjëherë – kur është e leverdishme, kur ka siguri, kur është korrekte nga ana sociale. Besimtarët e tillë janë pentekostalë me kohë të pjesshme. Ata e kanë këmbyer shenjtërinë me një publicitet të ekzagjeruar; e kanë harruar drejtësinë në ndjekjen e tyre të ritualeve; kanë zotëruar formën e fesë ndërkohë që sakrifikojnë forcën e Frymës.

Pentekostalët me kohë të pjesshme janë të krishterë që kërkojnë shumë vëmendje dhe që kanë pak ndikim. Ata mburren se kanë autoritet të madh, por shkatërrohen që me sulmin e parë të armikut. Ata i dinë të gjitha të drejtat biblike, por njohin pak nga përgjegjësitë e tyre.

Ekziston vetëm një kundërhelm ndaj një krize të tillë. Ky kundërhelm është marramendës në mundësitë e tij, është i mrekullueshëm në fuqinë që zotëron dhe është çlirues në ndikimin që ai ka. Dhe është shumë thjesht vajosja. Vajosja është fuqia e Frymës së Shenjtë. Pasi i kemi shqyrtuar të gjitha, nuk ka asnjë përkufizim më të mirë. Vajosja është fuqia e Perëndisë për të bërë punën e Perëndisë në një botë të paperëndishme.

Steve Franklin, themelues dhe president i Covenant Heirs International (Trashëgimtarët e Besëlidhjes), e përkufizon vajosjen shkurtimisht: "Vajosja është aftësi e mbinatyrshme për një detyrë të specializuar."²



Cila është detyra juaj e specializuar? Kush është deklarata e specializuar e misionit për kishën tuaj apo për shërbesën tuaj? Saktësisht ku përshtateni brenda kuadrit hyjnor të Urdhërimit të Madh? Vajosja do t'ju udhëheqë në identifikimin e asaj detyre dhe do t'ju fuqizojë në përmbushjen e saj.

që romakët kishin kryqëzuar një mësues nga Nazareti. U desh fuqia e Frymës për të depërtuar përmes kësaj injorance mashtruese dhe për ta çuar ungjillin – siç u komunikua nga Pjetri, Pali, Apoli dhe Prishila e Akuila – tek zemrat e shumicës së humbur. Luka e përmend Frymën e



Kam frikë se edhe nëse Fryma e Shenjtë do të hiqej plotësisht nga një kishë, shumë elemente të punës së asaj kishë do të vazhdonin sikur të mos kishte ndodhur asgjë.

FUQIA E FRYMËS ËSHTË E DOMOSDOSHMË QË KISHA TË ARRIJË POTENCIALIN E SAJ

Kur ne mendojmë për një detyrë, natyrshëm përfytyrojmë një objektiv. E kuptojmë detyrën që duhet të përmbushim. Shtrihet përpara nesh potenciali ynë i krijuar nga Perëndia. Ne duhet të jemi të fuqizuar nga Fryma nëse do të duam ta përmbushim atë potencial dhe ta realizojmë atë objektiv.

Kisha e Hershme nuk ishte e mirë për shkak të mirëqenies, planifikimit, madhësisë apo strukturës. Libri i Veprave të Apostujve nuk e reklamonte Kishën. Të krishterët e hershëm ishin njerëz shumë të zakonshëm që përballeshin me atë tallje dhe kundërshtim me të cilin kisha vazhdon të përballët.

Udhëheqësit e tyre kishin sfonde të dyshimta dhe shumica as nuk ishin të shkolluar mirë (4:13).

- Ata kishin burime të kufizuara financiare (4:32).
- Pësuan tortura nga smira e njerëzve (5:17; 17:5).
- Takoheshin nëpër shtëpi (Veprat 5:42).
- Përballeshin me racizëm (10:15).
- Besëtytnitë mbizotëronin (14:11).
- Ata ndesheshin me legalizmin (15:1,2).
- U ndeshën me paganizmin (17:22,23).
- Ballafaquan magjinë (19:19).

Kisha e Hershme ishte e mirë për shkak të pranisë së Perëndisë. Fryma i fuqizoi këta ndjekës të Krishtit për të ndikuar dhe për t'i dhënë formë një bote e cila, në vend që ta njihte Mesian, beson te

Shenjtë (ose Frymën) 55 herë në 28 kapituj. Fryma e Shenjtë është personazhi kryesor në librin e Veprave të Apostujve. Fryma e bëri potencialin e Kishës të kthehet në një realitet botë-ndryshues.

NJË KISHË E FUQIZUAR NGA FRYMA ËSHTË NJË KISHË MISIONI

“Por do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju dhe do të më bëheni dëshmitarë në Jerusalem dhe në gjithë Judenë dhe Samarinë dhe deri në skajin e dheut.” (Veprat e Apostujve 1:8)³.

Një nga Nenet e Besimit të përfshira në Përkushtimin e Cape Town, Afrika e Jugut – dokumenti i krijuar në qytetin Cape Town në 2010: Kongresi i Tretë i Lozanës mbi Ungjillizimin e Botës – thekson rëndësinë e Frymës së Shenjtë tek misioni i Kishës. “Ne e duam Frymën e Shenjtë brenda unitetit të Trinisë, së bashku me Perëndinë Atë dhe Perëndinë Bir. Ai është Fryma misionar i dërguar nga Ati misionar dhe Biri misionar, duke i dhënë frymë jete dhe fuqie Kishës misionare të Perëndisë. Ne e duam Frymën e Shenjtë dhe lutemi për praninë e Frymës së Shenjtë, sepse pa dëshminë e Frymës ndaj Krishtit, dëshmia jonë është e kotë. Pa punën bindëse të Frymës, predikimi ynë është i kotë. Pa dhuntitë, udhëheqjen dhe fuqinë e Frymës, misioni ynë është thjesht një përpjekje njerëzore. Dhe pa frytin e Frymës, jetët tona të shëmtuara nuk mund të reflektojnë bukurinë e ungjillit.”⁴

Misiologu i respektuar Arthur Glasser është shprehur në këtë mënyrë: “Kështu pra, ne nuk duam ta kufizojmë Frymën e Shenjtë vetëm për punën e besimit rizgjues (shfajësimit pra), dhe për punën e besimit perfeksionues (shenjtërimit).

Fryma në radhë të parë duhet parë si forca hyjnore pas çdo lëvizjeje të jashtme të popullit të Perëndisë, përtej kufijve të besimit, për të ndarë ungjillin me ata të cilët nuk e kanë dëgjuar akoma atë. Mision do të thotë lëvizje nga Krishti me anë të Frymës drejt botës që Ai pajtoi. Si i tillë, misioni qëndron në kontrast të madh ndaj vetë-kënaqësisë individualiste apo kishtare e cila është aq e zakonshme në segmente të mëdha të skenës moderne të krishterë.”⁵

Miku im Denny Miller ka shkruar gjerësisht rreth Frymës së Shenjtë dhe rreth misionit të Perëndisë. Në librin e tij, “Fryma e Perëndisë në Mision”, ai shkruan: “Kisha përballlet me një sfidë të madhe. Para më shumë se 2000 vjetësh, Jezusi e porositi kishën e Tij ta çonte ungjillin tek çdo komb dhe popull në tokë (Mateu 28:18-20; krahaso me vargun 24:14). Sot, si kurrë më parë, ai qëllim është shumë afër arritjes. Misiologët flasin sot për *përfundim* ose për plotësim të urdhërimit të Krishtit.”⁶

Si mund të ndodhë kjo? A është e mundur? Është e mundur vetëm me mundësimin e Perëndisë.

Kur Luka i shkroi Kishës së Hershme, shumë prej tyre e kishin humbur entuziazmin e tyre frymëror dhe zellin misionar. Receta hyjnore që Luka dokumentoi për efikasitet në mision ishte me qëllim që njerëzit e Perëndisë të fuqizoheshin nga Fryma e Shenjtë dhe të përkush-toheshin në mënyrë radikale ndaj misionit të Krishtit. Ne fuqizohemi si rezultat i një përvoje frymërore të quajtur pagëzim në Frymën e Shenjtë. “Ashtu si Jezusi kishte kërkuar që dishepujt e Tij të mbusheshin me Frymën e Shenjtë para se të fillonin shërbesat e tyre, edhe apostujt kërkuar që dishepujt e tyre të mbusheshin

Përtej mbledhjes së të vërtetave simbolike nga personazhe mitike, si ndjekës të Krishtit ne mund të përjetojmë një prani shumë reale përtej aftësive njerëzore. Ne mund të jemi të fuqizuar nga Fryma e Shenjtë.

me Frymën përpara se të fillonin shërbesat e tyre. Në këtë mënyrë, puna do të vazhdonte drejt progresit dhe do të bënte përpara pa u zvogëluar.”⁷

Le të besojmë për një ripërtëritje të freskët, për një derdhje të fuqishme të fuqisë së Perëndisë.

AVANTAZHET E FUQIZIMIT NGA FRYMA

“Sepse, sikurse në një trup kemi shumë gjymtyrë dhe të gjitha gjymtyrët nuk kanë të njëjtin funksion, kështu edhe ne, megjithëse jemi shumë, jemi një trup në Krishtin dhe secili gjymtyrë të njëri-tjetrit. Dhe, duke pasur dhunti të ndryshme sipas hirit që na u dha, [le t'i përdorim].” (Romakëve 12:4-6).

“Dhe ju keni vajosjen nga i Shenjti ... vajosja që keni marrë nga ai, rri në ju.” (1 Gjoni 2:20, 27).

“Krishti në ju, shpresa e lavdisë.” (Kolosianëve 1:27).

Konsiderojeni se kush është Krishti. Ai është i Vajosuri. Ky është kuptimi i emrit të tij, kështu jetoj dhe shërbeu Ai, dhe kështu e fuqizoi Fryma e Shenjtë Atë për të përmbushur misionin e Tij jetë-dhënës. Po ti, si do t'ia dalësh? Duhet të integrohesh me vajosjen e Frymës të secilës dhunti që Perëndia të ka dhënë, të çdo mase urtësie me të cilën je bekuar, të çdo burimi njerëzor që është vënë në dispozicionin tënd.

Për të kuptuar se si Fryma e Shenjtë e ndihmon secilin prej nesh të përdorë dhuntinë e tij apo të saj, mendoni pak për elektricitetin. Elektriciteti është i përgjithshëm në rrjedhën e tij, por

specifik në prodhimin e tij. Kur rryma elektrike rrjedh në shtëpinë tuaj, atëherë është i përgjithshëm; por çfarëdo që ju fusni në prizë përcakton prodhimin e tij. Nëse vini në prizë një ngrohës, do të përftoni ngrohje. Nëse vini në prizë një kondicioner, do të përftoni ajër të freskët. Kur

Fryma e Shenjtë ju vajos, ju qartësoni dhe theksoni dhuntinë tuaj. Nëse jeni një mësues, do të jepni mësim më mirë. Nëse drejtoni adhurimin, do të adhuroni më mirë. Predikuesit predikojnë më mirë, dhënësit japin më shumë dhe me gëzim më të madh dhe çdo shërbestar zhvendoset drejt përgjegjësisë të tij apo të saj me vizion dhe me epërsi.

VAJOSJA DO T'JU NDIHMOJË TË BËHENI MË SHUMË SE SA JENI

Veprat e Apostujve 1:8 premtan, “Por ju do të merrni fuqi. ...”

Fryma ndihmoi një bari të ri të bëhej një mbret, peshkatarët të bëheshin dishepuj, një vrasës në Egjipt të bëhej çliruesi i një kombi skllav, dhe një marangoz të bëhej Mesia.

Konsiderojini në lutje detyrat që Perëndia ka vendosur para jush. A duken pengesat si male? E njëjta Frymë fuqie e premtuar në Dhiatën e Vjetër dhe atë të Re dëshiron t'ju japë atë që duhet të bëni, atë që Perëndia do që ju të bëni.

“Jo për fuqinë dhe as për forcën, por për Frymën tim’, thotë Zoti i ushtrive.” (Zakaria 4:6).

VAJOSJA DO T'JU NDIHMOJË TË THONI MË SHUMË SE SA DINI

Tek Veprat e Apostujve 2:4, kur ata 120 veta folën në gjuhë të panjohura, Fryma i vajosi ata për të folur. Fjala në greqisht është *apopthengomai*. Ata folën në gjuhë të cilat ata nuk i njihnin. Kjo fjalë do të thotë “fjalim i frymëzuar nga Fryma”.

Ditën e Rrëshajëve, Pjetri u ngrit dhe iu drejtua turmës dhe në gjuhën e tij amtare ai predikoi atë që në greqisht quhet “fjalim i frymëzuar nga Fryma” (Veprat 2:14). Kjo fjalë është *apopthengomai*. Në të njëjtën mënyrë Fryma e Shenjtë frymëzoi gjuhët e panjohura – gjuhë që nuk i njohim – Pjetri foli në gjuhën e tij dhe Fryma e Perëndisë në mënyrë të barabartë frymëzoi atë.

Kur Fryma e Shenjtë na vajos, Ai i merr fjalët tona dhe i përdor ato në mënyrë të mbinatyrshme. Si një përgjigje ndaj predikimit të Pjetrit, njerëzit ishin të prekur thellë në zemër dhe duhej të reagonin. Turma u zhvendos nga pyetja: “Çfarë do të thotë kjo?”, tek pyetja: “Çfarë duhet të bëjmë?”. Tre mijë veta u shpëtuan. Kur vajoseni nga Fryma e shenjtë ajo që thoni në treg apo çfarë thoni nga foltorja nuk duhet të jenë fjalët tuaja, por ajo që ju thoni është fjalim i frymëzuar nga Fryma.

Ky udhëtim me Frymën e Shenjtë në fjalimin e frymëzuar nga Fryma fillon me pagëzimin nismëtar që Ai sjell, duke dhënë si provë të folurit në gjuhë të tjera të panjohura. Mos bëni gabim – një përvojë e fortë emocionale në lutje nuk është prova biblike për pagëzimin e Frymës, por *Glossolalia* është prova. Dhe ajo dhunti e gjuhëve të panjohura duhet të vazhdojë përgjatë rritjes suaj frymërore dhe shërbesës suaj.

Melvin Ho vëren: “Në mënyra thelbësore ajo që Fryma e Shenjtë mëson përmes Lukës dhe Palit është fakti që pagëzimi në Frymë, me gjuhët e panjohura si një provë fillestare, është edhe një përvojë normale, edhe një përvojë normative (Veprat 2:4; 1 Korintasve 14:5); lidhja midis dhuntisë së gjuhëve të panjohura si një veprim hiri dhe shërbesës është lidhja e vazhdimësisë. E para është nisja e të dytës duke rezultuar në një ndërtim në rritje të trupit dhe në zgjerim të mbretërisë së Perëndisë.”⁸

Disa prej jush ndiheni të papërshtatshëm, të padenjë, me faj, dhe të papërgatitur për shkak të dështimeve të së kaluarës. Por kur i dëshmoni një miku, kur jepni mësim në një klasë, ose kur merrni një vendim në treg mund të jeni duke dhënë fjalime të frymëzuara nga Fryma. Ju thoni ato që nuk keni studiuar, flisni rreth gjërave që nuk i keni mësuar, njerëzve të cilët nuk i njihni, e megjithatë ju jeni të saktë nga ana profetike me vlerësimin tuaj.

Kur takoni ata të cilët janë me shpirt të vrarë dhe zemërthyer dhe hapni gojën tuaj, do të keni nevojë për vajosjen e Frymës për të arritur botën e cila është shumë e lënduar që të mund të arrijë të shërohet përmes urtësisë dhe gojëtarisë njerëzore. Vajosja do t'ju ndihmojë të thoni më shumë nga ajo që dini.

VAJOSJA DO T'JU NDIHMOJË TË BËNI MË SHUMË SE SA MUND TË BËNI

Kur jeni të vajosur mund të fitoni beteja kundër mundësive të pamundura. Samsoni vrau 1000 veta me një nofull gomari. Shamgari vrau 600 vetë me një hosten qesh; Gedeoni i tejkaloi shanset e 450 me 1 kur 300 izraelitë mundën 135 mijë midianitë me trumbeta, vazo balte dhe pishtarë.

Çfarë vizioni ju ka dhënë Perëndia? A po e shumëfishon Ai pasionin që ndjeni për lagjen tuaj? Për komunitetin tuaj? Për botën tuaj? Në të njëjtën mënyrë që Perëndia mund të shumëfishojë aftësinë njerëzore në kundërshtim me armiqtë njerëzore dhe të lejojë një njeri të mposhtë me

qindra ose madje edhe 1000 vetë, Fryma e Perëndisë mund të shumëfishojë aftësinë njerëzore në shpëtimin e shpirtrave të humbur. Ndërsa riafirmoni besimin tuaj në fuqizimin e Frymës për jetën dhe për shërbesën tuaj, në të vërtetë nuk ekziston asnjë kufizim ndaj asaj që Perëndia mundet të bëjë përmes jush.

PREZANTONI PERSONIN E FRYMËS

Fryma e Shenjtë është një Person, jo një “gjë” dhe as thjesht një prani. Ai nuk është një qëndrim, atmosferë apo mjedis. Ai është një Person i cili flet, mendon, planifikon dhe është pafundësisht i urtë dhe i artikuluar.

Ndërsa bëni thirrje për një përqendrim me kohë të plotë tek Fryma, do të çlironi një vajosje të re për të shpallur lajmin e mirë dhe për të pasuruar ata që janë të varfëruar nga ana frymërore.

TË THIRRUR PËR TË SHPALLUR NGUSHËLLUESIN

“Dhe unë do t’i lutem Atit”, premtoi Jezusi, “dhe ai do t’ju japë një Ngushëllues tjetër, që do të qëndrojë përgjithmonë me ju.” (Gjoni 14:16).

Jezusi nuk ishte thjesht duke iu premtuar dishepujve të tij një burim tjetër fuqie i cili do të ishte aktiv gjatë mungesës së Tij; Ai po i drejtonte ata që të pranonin po atë prani fuqizuese të cilën ata e kishin vëzhguar në vetë jetën dhe shërbesën e Tij.

Jezusi...

- U lind me anë të Frymës (Luka 1:35).
- U fuqizua me anë të Frymës (Mateu 12:27,28).
- U drejtua me anë të Frymës (Luka 4:1).
- U vajos me anë të Frymës (Luka 4:18).
- U pagëzua me anë të Frymës (Gjoni 1:32).
- U ringjall me anë të Frymës (Romakëve 8:11).
- U bë shlyerja jonë e mëkatit me anë të Frymës (Hebrenjve 9:14).

Prandaj, në gjithçka që i komunikoni bashkësisë suaj rreth Krishtit, rreth misionit të Tij dhe rreth urdhërimit të Tij ndaj kishës së Tij, keni edhe përgjegjësinë dhe mundësinë shtesë për ta thirrur kishën të mbushet dhe të drejtohet me anën e Frymës së Shenjtë ashtu siç tregoi Shpëtimtari gjatë gjithë jetës së Tij.

“Nuk do të flasë prej vetes, por do të flasë atë që do të dëgjojë.” (Gjoni 16:13).

Aspekti më i rëndësishëm i punës së Frymës së Shenjtë nuk janë dhuntitë e Tij, frymëzimi i Tij, krijimet e Tij të mundësive, manifestimet e Tij apo mrekullitë e Tij – por është personaliteti i Tij. Ai është përmbaruesi i Perëndisë, Ndihmuesi ynë në dobësitë tona, burimi i fuqisë për mënyrën tonë të perëndishme të jetesës, zbuluesi i vullnetit të Perëndisë, fuqia e ndërmjetësimit tonë, Fryma e rigjenerimit tonë. Në secilin kapacitet, Ai është aktiv si një Person hyjnor në jetët tona.

Në Ditën e Rrëshajëve, Fryma e Shenjtë erdhi mbi Kishën e Hershme në mënyrën më personale të mundshme. Për të lidhur kishën tuaj në mënyrë intime me Personin e Frymës së Shenjtë, duhet të jeni të vendosur për të krijuar një atmosferë ftuese për të kërkuar Pagëzimin. Kjo nuk kërkon një seri të veçantë predikimesh, një folës mysafir apo një thirrje për rizgjim (edhe pse secila prej këtyre strategjive ka një vlerë në vetvete). Nëse do të jeni të qëllimshëm rreth idesë për ta vendosur pagëzimin në frymë përpara kishës tuaj gjatë predikimeve tuaja, gjatë ftesave tuaja të altarit, në klasat tuaja të shkollës së të dielës, në grupet tuaja të vogla dhe madje edhe në buletin e kishës tuaj apo në publikime të tjera, ajo strategji ngopëse do të japë shumë rezultat. Do të shihni një shumëfishim të pagëzimeve në Frymë, dhe kisha juaj do të përjetojë fuqi për shërbesë efikase që shoqërohet me atë bekim.

SHPALLNI TË VËRTETËN E FRYMËS

“Dhe unë do t’i lutem Atit dhe ai do t’ju japë një Ngushëllues tjetër, që do të qëndrojë përgjithmonë me ju, Frymën e së Vërtetës” (Gjoni 14:16,17). Ndërsa komunikoni të vërtetat e Fjalës së Perëndisë në aktivitetet e shumta të shërbimit tuaj pastoral, kapni fort secilën mundësi për t’i drejtuar njerëzit drejt Frymës, i cili e gjallëron atë të vërtetë.

Në një epokë dhe një kulturë e cila e ka rrëmbyer, holluar dhe e ka larguar të vërtetën për ta çuar drejt relativizmit, insistoni që një marrëdhënie e përditshme me Personin e Frymës së Shenjtë do të injektojë në jetët e besimtarëve qartësi të vizionit dhe të qëllimit.

MIRATONI MËSIMET E FRYMËS

“Por Ngushëlluesi, Fryma e Shenjtë, që Ati do ta dërgojë në emrin tim, ai do t’ju mësojë çdo gjë dhe do t’ju kujtojë të gjitha këto që ju thashë.” (Gjoni 14:26). Epoka jonë është një epokë e burimeve të informacionit gjithmonë e më tepër në zgjerim. E megjithatë, duke pasur miliarda fakte nën majat e gishtave tanë, njohuria jonë mund të bëhet dy kilometra e gjerë dhe pak milimetra e thellë.

Ballafaqojini anëtarët e bashkësisë tuaj me një vizion të përtërirë të Frymës si Mësues hyjnor. Ai mund të drejtojë dhe udhëheqë në mënyrë shumë më koncize dhe më efikase se sa çdo libër vetë-ndihmues shumë i shitur, se çdo ekspert i vetë-identifikuar dhe se çdo ekspert i masmedias të marra së bashku.

JETONI NË FITOREN E FRYMËS

“Fryma e Zotit është mbi mua, sepse ai më vajosi për të ungjillëzuar të varfrit; ai më dërgoi për të shpallur çlirimin e të burgosurve dhe kthimin e të parit të verbërve, për të dërguar në liri të shtypurit, dhe për të predikuar vitin e pranueshëm të Zotit.” (Luka 4:18, 19).

Çdo herë që qëndroni përpara kishës suaj, ju hidhni sytë mbi një det sfidash të jetës dhe pikëllimesh të ndryshme. Por asnjë pengesë nuk është e pakapërcyeshme për Frymën, asnjë zemër-thyerje nuk është tepër e madhe për të pranuar ngushëllimin e Tij të mbinatyrshëm. Ndërsa bëni thirrje për një përqendrim me kohë të plotë tek Fryma, do të çlironi një vajosje të re për të shpallur lajmin e mirë dhe për të pasuruar ata që janë të varfëruar nga ana frymërore. Do të shpallni liri nga çdo formë skllavërie. Do t’i drejtoni të verbrit frymërorë drejt një vizioni të ri të dashurisë

së Atit dhe të sakrificës së Shpëtimtarit. Do të shkatërroni shtypjen e armikut.

Në fuqinë e Frymës, ju dhe kisha juaj mund të filloni një vit të favorit të Zotit që nuk e keni përjetuar kurrë më parë.



L. ALTON GARRISON, asistent i shefit të përgjithshëm për Këshillin e Përgjithshëm të Asambleve të Perëndisë, Springfield, Misuri

Shënimet

1. A.W. Tozer, Of God and Men (Harrisburg, Pennsylvania: Christian Publications Inc., 1960), 35.
2. Raymond F. Culpepper, No Church Left Behind (Cleveland, Tennessee: Pathway Press, 2007), 102.
3. Bibla e Shenjtë. Për vargjet e Biblës është përdorur Bibla, Dhjata e Vjetër dhe Dhjata e Re, copyright 2012, ABS: Shoqëria Biblike Shqiptare, SH.B.Sh. Tiranë, Shqipëri.
4. “The Cape Town Commitment” 1.5, quoted by Gary Tyra, The Holy Spirit in Mission (Downers Grove, Illinois: Inter Varsity Press, 2011), 11.
5. Ibid, 34, quoting Glasser, Announcing the Kingdom, 263.
6. Denzil R. Miller, The Spirit of God in Mission (Springfield: Pneuma Life Publications, 2011), 233.
7. Ibid, 234.
8. Melvin H., “A Comparison of Glossolalia in Acts and Corinthians,” (Assemblies of God, Value online articles) [<http://agchurches.org/Sitefiles/Default/RSS/IValue/Resources/HolySpirit/Articles/Glossolalia.pdf>], faqja është parë më datë 21 Janar 2013.

© 2013. Paul F.Gray



Shyqo ka rritur ofertën vullnetare - dmth 5-lekshin po njësoj e hedh, por pushi i xhepave është dyfishuar!

*Mendime
të
Vjera*

nga



Kapari i Trashëgimisë

Nga: Mark Wootton

N

ga të gjitha mënyrat në të cilat është përshkruar Fryma e Shenjtë, një nga ato më interesantet duhet t'i atribuohet Palit. Ndërkohë që ishte në burg në Romë, Pali shkroi një letër për kishën në Efes.

Në kapitullin hyrës, ai deklaroi: “Në të edhe ju, pasi e dëgjuat fjalën e së vërtetës, ungjillin e shpëtimit tuaj dhe, pasi besuat, u vulosët me Frymën e Shenjtë të premtimit, i cili është kapari i trashëgimisë sonë, për shpengimin e pronës së fituar, për lëvdimin e lavdisë së tij.” (Ef 1:13–14).

Pali e quajti Frymën e Shenjtë “kapari i trashëgimisë sonë, për shpengimin e pronës së fituar” (v. 14). Në versionet e Biblës në gjuhën angleze, përkthime të ndryshme janë përpjekur të kapin kuptimin e kësaj fraze:

- “një depozitë që garanton trashëgiminë tonë”
- “kësti i parë i asaj që është duke ardhur”
- “një peng i lënë për trashëgiminë tonë”
- “kapari i trashëgimisë sonë [frytet e para, betimi dhe shijimi paraprak, paradhënia e trashëgimisë sonë]”
- “garancia e trashëgimisë sonë”

Kur një besimtar merr Frymën e Shenjtë, ai ose ajo është në fakt duke marrë një depozitë, një këst të parë, një shijim paraprak ose një kapar.

A keni dhënë ndonjëherë ndonjë kapar për një makinë apo për një shtëpi? Në fakt, çfarë po thoni me anë të këtij kapari? Ju jeni duke premtuar që do të ktheheni së shpejti me pjesën tjetër të çmimit të blerjes. Po i kërkonit shitësit ta ruajë për ju artikullin apo mallin e blerë dhe të mos ia shesë askujt tjetër. Jeni kaq të qëllimshëm për ta çuar deri në fund blerjen saqë bini dakord ta humbisni depozitën e bërë nëse nuk ktheheni me pjesën e mbetur të parave.

Për më tepër, ajo me të cilën do të ktheheni është e njëjtë me depozitën që po lini. Që do të thotë, në rast se po ktheheni me shumë para, shitësit do t'ju besojnë nëse lini një shumë të vogël parash. Ata mund të jenë të inkurajuar për të besuar që keni më shumë, në qoftë se u lini ca atyre. Kjo është provë e besnikërisë suaj. Tani, çfarë lidhjeje ka kjo me Frymën e Shenjtë?

Ndërkohë që Fryma e Shenjtë i vulos besimtarët në momentin e shpëtimit, kur besimtarët marrin pagëzimin në Frymën e Shenjtë, ata po marrin një shijim paraprak ose një kapar të parajsës. Ata kanë një pjesë të vogël të plotësisë. Pagëzimi në Frymën e Shenjtë u jep atyre privilegjin për të përjetuar tani pak nga parajsa. Për shembull, në qiell nuk do të ketë më sëmundje apo vdekje (Zbulesa 21:4).

Në mënyrë korresponduese, një nga dhuntitë e disponueshme me pagëzimin në Frymën e Shenjtë është dhuntia e shërimit (1 Kor 12:9). Shërimi që kryhet në tokë është i vërtetë, por gjithashtu i përkohshëm. Unë mund të shërohem nga kanceri e megjithatë më vonë vdes. Ndërsa në qiell, unë do të marr një trup të shëndetshëm e të lartësuar, i cili nuk do të sëmuret kurrë. Megjithatë, shijimi paraprak i një përvoje të tillë në tokë është vërtet një shpërblim shtesë.

Po ashtu, në qiell do të njohim sikurse njihemi (1 Kor 13:12). E megjithatë, tani, me Frymën e Shenjtë ka dhunti të njohjes dhe të urtësisë (1 Kor 12:8). Gjërat, që në mënyrë të natyrshme nuk do t'i dija, më janë zbuluar në mënyrë të mbinatyrshme. Por këto zbulesa për nga natyra janë të pjesshme. Prandaj edhe Agabi mund ta dinte që Pali do të arrestohej kur të mbërrinte në Jerusalem, megjithatë, nuk e dinte që Pali duhej të shkonte gjithsesi. Por, a nuk është e mahnitshme që ai e dinte se Pali do të arrestohej? Kjo fjalë njohurie ishte një shijim paraprak i asaj se si do të jetë parajsa.

Përshtkrimi i Frymës së Shenjtë si një kapar është një deklaratë fuqizimi. Tashmë e kemi përmendur fuqizimin për të dëshmuar dhe për një jetesë të shenjtë, por ka edhe më shumë. Kur një besimtar pagëzohet në Frymën e Shenjtë, ai ose ajo merr fuqi për të bërë vepra të mëdha, vepra qiellore. Megjithatë, për të qëndruar në temën e këtij kapitulli, bisedimin tonë do ta përqendroj tek veprat e mëdha që dishepujt e shekullit të parë ishin në gjendje të bënin me fuqinë e Frymës së Shenjtë.

Një këqyrje e shpejtë e Veprave të Apostujve zbulon këto mrekulli. Në kapitullin 3, Pjetri dhe Gjoni shëruan një njeri të çalë në derën e quajtur "E bukura". Në kapitullin tjetër, Sinedri u mahnit nga guximi i Pjetrit dhe Gjonit të cilët ishin të pamësuar dhe të patrajnuar. Kapitulli pesë raporton që Pjetri ishte në gjendje të dallonte që Anania dhe Safira po gënjenin; apostujt bënë shumë shenja dhe mrekulli, duke përfshirë shërimin e të sëmurëve dhe të atyre që ishin të pushtuar nga demonët; dhe madje edhe kur hija e Pjetrit u kalonte sipër njerëzve, sillte shërim për ta. Në kapitullin 8, shërbesa e Filipit në Samari përfshinte shërimin e atyre që ishin të paralizuar, të çalë dhe të pushtuar nga demonët. Më vonë, në

këtë kapitull ai u mor nga Fryma dhe u transportua për në Azot. Kapitulli i nëntë regjistron shërimin e Eneas nga Pjetri, këtij të paralizuari i cili dergjej në shtrat prej tetë vjetësh, dhe më pas u thirr në Lida ku ai ringjalli Tabitën nga të vdekurit. Kapitulli 11 shton që Agabi profetizoi për një zi buke të ardhshme. Më pas, në kapitullin 12, kisha u lut për çlirimin nga burgu të Pjetrit, dhe një engjëll iu përgjigj kërkesës së tyre.

Kur fokusi i librit të Veprave të Apostujve kalon tek Pali, ne e shohim atë gjithashtu të përfshirë në disa mrekulli të ndryshme. Në kapitullin 13, Pali e mallkoi magjistarin Elimas me verbëri. Në kapitullin 14, Barnaba dhe Pali kryen mrekulli dhe shenja në Ikon. Pastaj në Listra, Pali urdhëroi një person të paralizuar që nga lindja, që të ngrihej dhe të ecte. Kapitulli i gjashtëmbëdhjetë regjistron që Fryma e Shenjtë i ofroi udhëheqje hyjnore, e cila e parandaloi udhëtimin misionar të Palit për të shkuar në Azi ose Bitini dhe i drejtoi ata drejt Maqedonisë. Kur ishte në Maqedoni, Pali dëboi një frymë shortarie nga një vajzë fallxhore në Filipi. Në kapitullin 19, shamtë dhe përparëset e marra nga trupi i Palit përdorëshin për të bërë shërime dhe ekzorcizma. Kapitulli vijues tregon për një incident kur një i ri, Eutiku, u kthye në jetë nga Pali pasi të riun e zuri gjumi dhe ra nga dritarja e katit të tretë gjatë predikimit të Palit. Në kapitullin 21, Agabi profetizoi që Pali do të arrestohej kur të mbërrinte në Jerusalem. Në dy kapitujt e fundit të Veprave të Apostujve, një engjëll i shërbeu Palit gjatë një stuhie të egër dhe i tha atij që asnjë jetë nuk do të humbiste. Pas mbytjes së anijes, Pali nuk vuajti asnjë efekt nga kafshimi i një nepërke helmuese, sërisht Pali shëroi të atin e Publiusit nga ethet dhe dizenteria, dhe më pas të gjithë personat në ishull, që kishin sëmundje, erdhën të shëroheshin tek ai.

Pra, ja, siç e shihni, në pothuajse çdo kapitull është regjistruar një mrekulli ose shërim. Dhe singërisht, a mendoni ju se kjo ishte lista e plotë? A mund ta imagjinoni që janë bërë edhe më shumë mrekulli nga ato që u përmendën tek Veprat e Apostujve? Unë mendoj që po. Unë mendoj se kjo ishte thjesht një përzgjedhje shembujsh të atyre njerëzve të cilët u shëruan. Ishte vetëm një copëz e udhëheqjes dhe e zbulesës hyjnore që morën besimtarët e mbushur me Frymë gjatë kësaj kohe. Ishin vetëm disa nga ato pak mrekulli të cilat

© 2010. Janny Hawkins



Nuk është çudi që ata mezi e përtypin mishin nga Fjala. Edhe unë vetë jam vegetarian shpirtëror..!

ndodhën përreth bregut të detit Mesdhe. Ishte pothuajse sikur qielli të kishte zbritur në tokë. Në fakt, kjo ishte pikërisht ajo që kishte ndodhur. Si një depozitë përjetësie, Fryma e Shenjtë, iu ishte dhënë besimtarëve në të gjithë zonën. Pjesëza nga qielli po shfaqeshin ngado. Njerëzve po iu jepej një shijim paraprak i tablosë se si do të ishte kur ata më në fund do të arrinin në shtëpinë e tyre qiellore. Ishte një kapar i trashëgimisë së tyre pikërisht këtu në tokë!

Ndoshta lista më e përdorur e shumëllojshmërisë së këtyre punëve të mëdha janë dhuntitë e Frymës së Shenjtë të cilat gjenden të renditura tek 1 Korintasve 12. Kjo listë shërben si një shembull ndaj atyre personave që janë në Kishë, për mënyrat se si Fryma e Shenjtë do t'u japë atyre një shijim paraprak të qiellit. Aty ka dhunti të njohjes hyjnore si urtësia, dallimi dhe njohuria. Ka dhunti të fuqisë siç janë mrekullitë, besimi dhe shërimet. Gjithashtu ka edhe dhunti të të folurit, siç janë gjuhët e panjohura, interpretimi i gjuhëve të panjohura dhe profecia. Të gjitha këto janë mënyra të cilat fuqia e mbinatyrshme e qiellit mund t'i fillojë në natyrshmërinë e tokës. Këto janë më shumë sesa thjesht demonstrime të fuqisë. Ato janë depozita të planifikuara nga pikëpamja hyjnore që na tregojnë një copëz të qiellit.

Prandaj, pentekostalët e plotë jo vetëm që flasin në gjuhë të panjohura, por gjithashtu kuptojnë që po mbartin një depozitë përjetësie.

Ajo depozitë është një dhunti e fuqizimit, jo për t'u

mburrur, por për të shërbyer tani hirin e përjetshëm, shërimin dhe çlirimin e Perëndisë. Kjo depozitë është një privilegj i madh dhe një përgjegjësi e madhe. Fuqizimi që sigurohet nga kjo depozitë është për çlirimin nga dobësia tokësore e përkohshme dhe gjithashtu për dëshminë ndaj një Ati të dashur të përjetshëm. Duke përdorur shembullin e Krishtit në tokë, shërimi hyjnor shpesh ka për qëllim të drejtë drejt pendimit dhe shpëtimit. Është fuqizim për korrësit e kohëve të fundit për të bërë punën e tyre.

Në mbyllje, pagëzimi në Frymën e Shenjtë është një shijim paraprak i qiellit. Krishti, për të na dhënë një siguri që Ai do të vijë sërish, na jep një depozitë të qiellit, një paradhënie përfaqësuese. Fryma e Shenjtë na jep tani një shikim të pjesshëm të përfitimeve dhe përvojës së të jetuarit në qiell. Duhet të jemi më të bindur që Jezusi do të kthehet për të na çuar në shtëpi sepse tani kemi Frymën e Shenjtë. Gjithashtu duhet të kuptojmë që jemi të fuqizuar për të bërë punën e Mbretërisë derisa Mbretëria e Tij të vijë.

Ka raste kur njerëz të ndryshëm më pyesin: "A je pentekostal?" Unë mendoj që ajo që ata duan të dinë është nëse flas në gjuhë të panjohura. Ajo që dua t'u them është: "A po pyesni nëse jam dikush të cilin Perëndia e ka veçuar për punë në arën e Tij të të korrave deri kur Ai të kthehet? A jam unë dikush mbi të cilin ka zbritur lavdia e mahnitshme e Perëndisë, duke më vajosur për të jetuar një jetë të shenjtë dhe që të jem një bekim për këtë botë? A jam dikush të cilit i është besuar një depozitë e qiellit për të më dhënë siguri dhe fuqi për të jetuar në këto kohë të fundit?" Nëse kjo është pyetja e tyre, atëherë: "Po, jam pentekostal!" Jam ai lloj pentekostali.

Ky artikull është marrë nga "THE COMPLETE PENTECOSTAL More Than Just Tongues" (Pentekostali i Plotë, më shumë se Thjesht Gjuhë të Panjohura)

© 2010 nga Mark Wootton. Përdorur me lejen e autorit. Të gjitha të drejtat të rezervuara në mbarë botën.



MARK WOOTTON, D.Min., është profesor i Udhëheqjes Pentekostale në universitetin Evangel. Ai ka shërbyer si pastor, kishëmbjellës, profesor dhe administrator universiteti.



Intervistë

me pastorin

Ervin Kodra

Nga: **KURT D. PLAGENHOEF**

Pastor Kurt: *Një ndër parimet e kishës vendase është vetë-mbështetja. Pse besoni se kjo është diçka kritike për rritjen e kishës?*

Pastor Ervin: Vetë-mbështetja është e rëndësishme sepse ajo është mënyra biblike që kisha të rritet dhe të shumëfishohet. Ndërkohë që kisha është besnike për të marrë përgjegjësinë për shërbesën e saj dhe pastorin, Perëndia plotëson të gjitha nevojat e popullit dhe të veprës së tij.

Pastor Kurt: *Në tri vitet e kaluara, kisha "Uji i Jetës" ka përjetuar një rritje eksponenciale për sa i përket anës financiare. Ju lutem, na flisni për këtë dhe na shpjegoni kujt ia atribuoni këtë rritje.*

Pastor Ervin: Kur jemi besnik për t'i dhënë Zotit të dhjetën e tij, ai është besnik për t'i plotësuar të gjitha nevojat tona. I kam dhënë mësim kishës në mënyrë të drejtpërdrejtë që dhënia e së dhjetës dhe ofertës është një urdhër nga Perëndia. Pastaj ata e kanë zbatuar dhe janë bërë dhënë të gëzuar dhe të bekuar.

Kemi kuptuar që zemra e Zotit është për misionin. Në vitin 2011, Zoti na bekoj me një ofertë të madhe nga një individ. Edhe pse kemi pasur shumë nevojë për këtë ofertë në kishën tonë, kemi vendosur që ta japim ofertën për misionin. Pastaj, për tri vite kemi dhënë 20% të të ardhurave të kishës për misionin. Tani japim 10% për misionin.

Si rezultat, të ardhurat e kishës janë shtatëfishuar për dy vjet. Përafërsisht gjysma e besimtarëve kanë punë dhe pothuajse të gjithë, rreth 90% janë besnikë në dhënien e së dhjetës dhe e mbështesin pastorin me kohë të plotë.

Pastor Kurt: *Si iu përgjigjeni njerëzve që thonë se shqiptarët janë shumë të varfër për të dhënë?*

Pastor Ervin: Në Shqipëri, kisha ka luftuar me këtë ide: që besimtarët nuk kanë se çfarë të

ofrojnë. Kjo nuk është e vërtetë. Duhet të punojmë shumë, të besojmë shumë, dhe të japim atë që kemi, dhe Zoti do të sigurojë. Ka mijëra mundësi për punë në Shqipëri. Kur kërkojmë fort dhe mirë-administrojmë atë që kemi, Zoti shumëfishon atë që ne japim, qoftë pak ose shumë.

Pastor Kurt: *A kanë përgjegjësi kishat që t'i suportojnë pastorët e tyre? Cila është baza biblike për këtë gjë?*

Pastor Ervin: Po. Baza biblike është ajo që tha Pali: "Ata që predikojnë ungjillin, duhet të jetojnë nga ungjilli". Në Dhiatën e Vjetër, prifti hante bukën e shenjtë në shtëpinë e Zotit. Edhe në Dhiatën e Re deri më sot, ajo që ne japim është për shërbëtorët e Zotit në kishë dhe për punën e kishës së tij.


Pastor Kurt: *Çfarë fjale të fundit inkurajimi do të donit të ndanit me kolegët tuaj në shërbesë për dhënien e mësimit mbi të dhjetën dhe ofertën në kishën lokale?*

Pastor Ervin: Ne si pastorë duhet të jemi shembull. Ai që vjen tek Perëndia ka marrë dhe duhet të japë. Ne si besimtarë të rritur, të pjekur, dhe të përkushtuar ndaj Zotit duhet të japim gjithçka. Kur isha 18 vjeç, për herë të parë mora 1,000 lek nga puna. Kur isha në kishë, Zoti më tha: "Kjo shumë nuk është e jotja. Duhet ta japësh në ofertë". Këto para ishin shumë të vlefshme për mua, por unë ia dhashë Zotit. Qysh atëherë kam mësuar si të jap në mënyrë ekstreme. Pastaj Zoti ka qenë gjithmonë besnik për të plotësuar çdo nevojë që kam. Zoti asnjëherë nuk më ka lënë bosh. Pra, ju nxis që të provoni të dhënit në mënyrë ekstreme dhe të shikoni bekimet e Zotit. Bibla na tregon që më të bekuar janë ata që japin sesa ata që marrin. Le të besojmë dhe ta provojmë këtë parim, si dhe premtimet e Zotit.

DUKE I BESUAR PERËNDISË
për
DREJTUES
sipas
STILIT *të*
JEZUSIT

Nga: **James T. Bradford**

*Ku ta gjejmë një shembull për një mënyrë
më të mirë për të drejtuar? Jezusi modeloi
tri karakteristika përkufizuese të
udhëheqësisë pentekostale.*



Isha 19 vjeç dhe i tmerruar nga ideja e të qenit një drejtues. Meqenëse isha shumë i heshtur, shumë i turpshëm, shumë i pasigurt rreth vetes sime, nuk mund ta përfytyroja që unë të isha duke udhëhequr të tjerë. Por me kalimin e kohës ajo frikë, ashtu siç ndodh me shumë frikëra, rezultoi të mos kishte asnjë kuptim. Pas shumë viteve të mbushura me dyer të hapura dhe përvoja që më kanë zgjeruar horizontin, udhëheqja është bërë pjesë e identitetit tim. Përgjatë rrugës shumë njerëz kanë ardhur pranë meje në atë rrugë të gjatë drejt udhëheqjes. Shembujt e tyre më kanë sfiduar, inkurajimi i tyre më ka motivuar dhe mentorimi i tyre ka ndihmuar në formimin tim.

Pas dashurisë për Jezusin, udhëheqja e mirë dhe kalimi i stafetës së udhëheqësisë tek brezi i ardhshëm janë midis prioriteteve tona kryesore. E ardhmja jonë prehet edhe në favorin aftësues të Perëndisë, edhe në shfaqjen e udhëheqësve të shëndetshëm e transformues, të cilët do të ndërtojnë kisha dhe fushata me impakt të lartë e që janë të frytshme nga aspekti i misionit.

Udhëheqja është më shumë se sa thjesht t'i mbijetosh shërbesës nga java në javë. Udhëheqja sheh tablonë e plotë. Udhëheqja shqyrton të ardhmen dhe dëftën drejtimin nga duhet të shkojmë. Udhëheqja i ngre njerëzit dhe i ndihmon ata të arrijnë potencialin e tyre të dhënë nga Perëndia. Udhëheqja i inkurajon njerëzit të punojnë në skuadra dhe del nga skena që të aftësojë të tjerët për të përdorur dhuntitë e tyre të shërbesës.

Fatkeqësisht, nuk është gjithmonë kjo mënyra se si është udhëheqja në kishë. Në librin e tij "Jeta dhe Mësimet e Jezus Krishtit", predikuesi skocez James S. Steward vëzhgoi tablonë e udhëheqësisë fetare në kohën e Jezusit dhe e përmbloodhi atë kështu: "Farisenjtë kishin fe të mishëruar... skribët kishin fe të profesionalizuar... saducenjtë kishin fe të laicizuar... [dhe] zelotët kishin fe të kombëtarizuar." Një ditë, ndërsa po mendoja kuptova që, nëse nuk do të isha i kujdesshëm, udhëheqja fetare profesionale mund të më bënte të njëjtën gjë edhe mua. Kjo gjë, nëse do të ishte e pa kontrolluar, kishte fuqinë toksike për të më lënë sipërfaqësor nga ana e jashtme, të veçuar nga ana profesionale, një përbuzës të pashpresë dhe shumë të përfshirë politikisht.

Ku e gjejmë modelin për një mënyrë më të mirë? Tek Luka 6:12-19, Jezusi i përgjigjet kësaj pyetjeje me shembullin e Tij. Këtu, gjatë një momenti shumë të rëndësishëm më herët në shërbesën e Tij, ne ndeshemi me Jezusin udhëheqës. Në tri ngjarje të një pas njëshme Jezusi modeloi përjetësisht tri karakteristikat përkufizuese të udhëheqësisë pentekostale – udhëheqësi që është

frymërore, udhëheqësi që ka të bëjë me marrëdhëniet dhe udhëheqësi që ka të bëjë me misionin.

UDHËHEQËSIA PENTEKOSTALE ËSHTË FRYMËRORE

"Në ato ditë ndodhi që ai [Jezusi] shkoi në mal për t'u lutur, dhe e kaloi natën duke iu lutur Perëndisë." (Luka 6:12).

Jezusi u angazhua me çështjet nga ana frymërore përpara se të bënte ndonjë gjë tjetër. Drejtuesit e mirëfilltë pentekostalë bëjnë të njëjtën gjë. Motoja jonë është më shumë se sa thjesht një retorikë: *"Jo për fuqinë dhe as për forcën, por për Frymën tim", thotë Zoti i ushtrive.*" (Zakaria 4:6).



Për fat të keq ekziston një tendencë shumë njerëzore për të shkëputur udhëheqjen publike nga cilësia frymërore personale. Chuck Miller, në librin e tij "The Spiritual Formation of Leaders" (Formimi Frymëror i Drejtuesve), e përshkruan kështu problemin: "Kisha ka qenë e prirur që t'i orientojë drejt udhëheqësisë njerëzit e tipit A të personalitetit dhe drejt lutjes dhe natyrës frymërore njerëzit që janë më reflektues. Dhe përfundojmë duke i detyruar njerëzit të bëjnë një zgjedhje të pa nevojshme midis frymërores dhe udhëheqjes".

Megjithatë, ky është një degëzim artificial dhe i panevojshëm. Cilësia frymërore personale dhe udhëheqja publike duhet të ecin dorë për dorë. Shumica prej nesh që jemi në pozicione drejtuese, lutemi shumë pak dhe punojmë më tepër nga sa duhet. Por mënyra e jetesës në lutje e Jezusit na kujton që udhëheqja në kishën e Tij, para së gjithash, është një aktivitet frymëror. Ajo kërkon që

të thellohem përpara se të zgjerohemi. Burra dhe gra të Perëndisë gjatë gjithë historisë kanë besuar që, në qoftë se do të kujdesemi për thellësitë e jetëve tona, atëherë Perëndia do të kujdeset për gjerësinë e ndikimit tonë. Kjo është thellësia përpara gjerësisë, intimiteti me Krishtin përpara punës për Krishtin.

Në këmbim, ky intimitet e ndez më shumë shërbesën e mbinatyrshme. Miles Sanford, në librin e tij rreth dishepullizimit, liston emrat e shumë heronjve të besimit përgjatë 200 viteve të fundit – njerëz si Jonathan Goforth, D. L. Moody, Amy Carmichael, John Hyde, Hudson Taylor, George Mueller dhe shumë të tjerë. Më pas, ai bën një vëzhgim të mprehtë që këtyre udhëheqësve të mëdhenj frymërorë iu deshën mesatarisht 15 vjet për të kaluar nga njerëz që “punonin për Krishtin” në njerëz “përmes të cilëve punonte Krishti”.

Ky është gjithashtu edhe rrugëtimi ynë si udhëheqës pentekostalë. Duke qenë të mbushur me Frymën, jemi krasitur në mënyrë që të japim më shumë fryt (Gjoni 15:2). Ne lëmë gjithmonë e më pak përshtypje tek vetja jonë dhe jemi gjithnjë e më shumë të bindur që pa jetën e Jezusit nuk mund të bëjmë asgjë (Gjoni 15:5). Si rrjedhojë, fillojmë të gjejmë kënaqësi duke qëndruar në Krishtin (Gjoni 15:7) përmes vdekjes së vetvetes

Afrimi i njerëzve dhe pajisja e tyre për shërbesë kërkon që të veprojmë më shumë si shërbyes se sa si yje kinemaje, më shumë si trajnerë, se sa si diktatorë dhe më shumë si shokë, se sa si profesionistë.

sonë, duke pasur uri për Perëndinë, duke e kredhur veten në Fjalën e Tij dhe duke ecur në fuqinë ringjallëse të Krishtit. Me pak fjalë, kalojmë nga të qenit të varur te vetja, tek të jetuarit me anë të Frymës së Tij, nga të qenit të fokusuar në përpjekjet tona, tek të ecurit në jetën e Tij.

Gjatë një kohe veçanërisht pa progres gjatë shërbesës sime si pastor, Zoti më foli për të shkuar në shenjtëroren e kishës disa ditë në javë, të ecja përgjatë rreshtave të karrigeve dhe të mos bëja asgjë tjetër veçse të lutesha në Frymë për një orë. Kisha mirë ishte, por unë kisha ardhur afër fundit të krijimtarisë sime dhe më kishin mbaruar idetë. Po mbahesha mirë, por ndihesha sikur nuk dija se si ta udhëhiqja kishën për në shkallën tjetër.

Duke ecur në bindje nëpër atë shenjtërore dhe duke u lutur në gjuhë të panjohura, Zoti po mundësonte që unë të takohesha me Të në pikën e fundit të vetes sime. Ai po shkarkonte nga unë

presionin për të ardhmen e kishës dhe po e merrte atë mbi vete. Fryma e Shenjtë po lutej përmes meje me mendjen e Atit (Rom. 8:27) kur mendja ime nuk dinte më se si të lutej. Ishte mëshira e Perëndisë ajo që më solli mua në këtë pozitë. Përgjatë viteve të ardhshme, përjetova një lehtësi dhe frytshmëri që nuk e kisha përjetuar më parë gjatë udhëheqjes së asaj kishë.

Udhëheqësia Pentekostale sipas stilit të Jezusit është para së gjithash frymërore. Kjo do të thotë të luteni shumë dhe të keni besim. Këtu filloi edhe Jezusi – në fillim 40 ditët në shkretëtirë dhe pastaj netët e veçanta të lutjes para çdo hapi të ardhshëm strategjik e të vazhdueshëm në shërbesë. Më vonë, për Kishën e Hershme kjo do të thoshte që të shkonin në Dhomën e Sipërme përpara se të dilnin në sheshet e jashtme, të kishin Ditën e Rrëshajëve përpara marrjes së një trashëgimie të një shërbese botë-ndryshuese.

UDHËHEQËSIA PENTEKOSTALE KA TË BËJË ME MARRËDHËNIEN

“Dhe si zbardhi dita, thirri pranë vetes dishepujt e vet dhe zgjodhi prej tyre dymbëdhjetë, të cilët i quajti apostuj” (Luka 6:13).

Jezusi e dinte që nuk do t'i shërbente misionit të Tij më të gjerë vetëm duke iu predikuar turmave të mëdha. Në librin e tij që tashmë është bërë klasik, *“The Master Plan of Evangelism”* (Master Plani i Ungjillizimit), Robert Coleman shkruan: “Ndërkohë që kisha po kërkon metoda për të lëvizur turmat, Perëndia po kërkon burra [dhe gra] të cilët do t'i ndjekë turma”. Njerëzit janë rendi i ditës i Perëndisë. Prandaj, menjëherë pasi kaloi gjithë natën në lutje, Jezusi zgjodhi 12 burra për të qenë me Të dhe për të ndarë autoritetin e Tij.

Shpeshherë e kam dëgjuar shefin tonë të përgjithshëm, Dr. George O. Wood, të thotë: “Shërbesa rrjedh prej marrëdhënies”. Në thelbin e vet, mbretëria e Perëndisë ka të bëjë me marrëdhënien. Jezusi e kuptoi këtë gjë dhe e jetoi atë. Në një pikë të caktuar në fillim të jetëve tona udhëheqëse, edhe ne gjithashtu, duhet të marrim përgjegjësi për të pasur njerëz përreth nesh të cilët na njohin mirë, dinë si të luten specifikisht për ne dhe të cilët dinë se si të jenë partnerë në shërbesë bashkë me ne. Këta janë rrethi i ngushtë i njerëzve me të cilët jetojmë në shtëpi, shërbejmë në kishë dhe me të cilët krijojmë njohje si shokë. Ky rreth mund të përfshijë gjithashtu trajnerë të shërbesës dhe madje edhe jo të krishterë të cilët mund të ndihmojnë duke na mbajtur me këmbë në tokë dhe në kontakt.

Clarence St. John, shef i Rajonit të Minesotës, ka përshtatur për shërbestarët në rajonin e tij një

strategji të mrekullueshme që ka të bëjë me marrëdhëniet. Ai e ka ndërtuar këtë strategji mbi idenë pamore simbolike të të vendosurit të një dore lart, një dore jashtë dhe një dore poshtë. Dora lart është për të marrë eksperiencë nga drejtues me më shumë përvojë në shërbesë. Dora jashtë është monitorimi i kolegëve, duke ndihmuar shërbëtarë të tjerë që janë në një nivel të ngjashëm të përvojës. Dhe dora poshtë është që të investosh tek dikush që ka më pak përvojë.

fokusuara tek njerëzit. Shembulli i Jezusit e heq pak e nga pak ndjenjën tonë të zotërimit dhe na bën shërbëtorë ndaj potencialit frymëror të atyre që udhëheqim.

Në mënyrë acaruese, këtu është pjesa ku egoja jonë dhe pasiguritë që ne kemi, na fusin shkopin nën rrota. Përveçse të lutemi, të arrijmë që njerëzit e duhur rreth e rrotull nesh të kryejnë gjërat e duhura është një nga punët më të vështira dhe më të rëndësishme që bëjmë ne si drejtues.

Mënyra e jetesës në lutje e Jezusit na kujton që udhëheqja në kishën e Tij, para së gjithash, është një aktivitet frymëror. Ajo kërkon që të thellohemi përpara se të zgjerohemi.



Edhe pse koha jonë është e kufizuar dhe mund të jemi të ndarë gjeografikisht, ne kemi nevojë për njëri-tjetrin. Teknologjia po e bën këtë më të lehtë dhe tani kemi shumë pak justifikime. Nuk duhet të rrezikojmë që të udhëheqim vetëm. Çfarë do të ndodhte nëse çdo drejtues do të ngrinte një dorë lart, do të nxirrte një dorë jashtë dhe do të ulte një dorë poshtë? Jezusi e zgjati dorën e tij drejt 12 burrave tek Luka 6, pasi u lut gjithë natën, dhe duke bërë kështu vendosi një shembull udhëheqësie për të gjithë ata të cilët do ta ndiqnin.

Si udhëheqës, shembulli i Krishtit e riorienton në formë radikale mënyrën se si i kuptojmë rolet tona dhe si e shpenzojmë kohën tonë. Afrimi i njerëzve dhe pajisja e tyre për shërbesë kërkon që të veprojmë më shumë si shërbyes se sa si yje kinemaje, më shumë si trajnerë, se sa si diktatorë dhe më shumë si shokë, se sa si profesionistë. Stilet tona të udhëheqjes do të duhet të bëhen më pak të nxitura nga personaliteti dhe më shumë të

Por kur udhëheqim duke u nisur nga pasiguritë tona, bëhemi shumë vetëmbrojtës dhe zvogëlojmë potencialin e atyre që janë përreth nesh. Duke qenë të trembur se kemi individë të fortë në skuadrën tonë, ne mbahemi pas shërbesës sonë shumë fort dhe bëhemi shumë kontrollues. Si rrjedhojë, kjo gjë i zhvlerëson dhe i çmotivon njerëzit me dhunti dhe i mban ata larg. Një miku im pastor tha rreth kësaj që: “ne i marrim njerëzit më të zgjuar të kishës sonë dhe i vendosim ata në rolet më të pamendta”.

Jezusi dha modelin e një mënyre më të mirë për të udhëhequr. Në fillim të shërbesës së Tij, Jezusi vendosi që do t'i balanconte kërkesat e turmës me kohën për të ndërtuar marrëdhënie, për të personalizuar shërbesën, për të pajisur drejtues të mundshëm dhe për t'iu besuar njerëzve që të shërbejnë. Zjarri fuqizues për shërbesë i Rrëshajëve do të binte më vonë mbi të gjithë ata që ishin mbledhur, jo thjesht mbi disa drejtues. Në

Një Përkushtim ndaj Udhëheqjes Gjithëpërfshirëse Pentekostale

Në fokusin tonë mbi lavdërimin,

...ne nuk do të harrojmë lutjen;

Në fokusin tonë mbi udhëheqjen,

...ne nuk do të harrojmë dashurinë;

Në fokusin tonë mbi modelet e shërbesës,

...ne nuk do të harrojmë zërin e Frymës;


Në fokusin tonë mbi krijimtarinë,

...ne nuk do të harrojmë takimet frymërore;

Në fokusin tonë mbi drejtësinë sociale,

...ne nuk do të harrojmë një ungjill të

shprehur me fjalë.



thelb, Jezusi vendosi që jo vetëm t'u shërbente njerëzve, por që të shërbente *përmes* njerëzve. Deri në ditët e sotme, rritja e shumë kishave është e varur në atë vendim thelbësor të udhëheqjes.

UDHËHEQËSIA PENTEKOSTALE KA TË BËJË ME MISIONIN

Menjëherë pasi u lut gjithë natën dhe pasi zgjodhi bashkëpunëtorët e Tij më të afërt, Jezusi “zbriti bashkë me ta” tek një numër i madh njerëzish (Luka 6:17). “*Dhe ata që ishin të munduar nga frymëra të ndyra shëroheshin. E gjithë turma kërkonte ta prekte, sepse prej tij dilte një fuqi që i shëronte të gjithë*” (Luka 6:18,19). Udhëheqësia që ka të bëjë me marrëdhëniet dhe me natyrën frymërore përfundimisht duhet të bëhet udhëheqësi që ka të bëjë me misionin.

Jezusi, tek Veprat e Apostujve 1:8, e lidhi me vendosmëri Frymën me misionin: “*Por do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju dhe do të më bëheni dëshmitarë në Jerusalem dhe në gjithë Judenë dhe Samarinë dhe deri në skajin e dheut.*” Nuk mund të kemi identitet pentekostal nëse nuk e kemi misionin si prioritet dhe aktivitet. Pagëzimi në Frymën e Shenjtë nuk na jep asnjë alternativë përveçse që të jemi të prirur për mision dhe të përfshirë në mision, edhe në nivel lokal, edhe në nivel global.

Pas fazës frymërore dhe asaj që ka të bëjë me marrëdhëniet – lutja gjithë natën dhe zgjedhja e të Dymbëdhjetëve – Jezusi zbriti tek turma “me ta”, aty ku njerëzit ishin të sëmurë, të demonizuar dhe të humbur, por edhe aty ku “prej tij dilte një fuqi që i shëronte të gjithë” (Luka 6:18). Shembulli i tij na thërret edhe ne si udhëheqës të misionit që të shkojmë bashkë me të, dhe të ndryshojmë botën. Ana e brendshme dhe mungesa e vizionit për të arritur njerëzit e humbur e anashkalon atë që Perëndia është duke bërë dhe është fatale për të ardhmen tonë.

Lui Pastër jetoi gjatë një kohe kur mijëra njerëz vdisnin çdo vit nga tërbimi. Pastër, i cili ishte shkencëtar, kishte punuar për vite me radhë për një vaksinë. Ndërsa ishte gati duke filluar eksperimentimin mbi veten e tij, një qen i tërbuar kafshoi Joseph Meister, një djalë 9-vjeçar. Nëna e djalit iu lut Pastërit të provonte eksperimentin mbi djalin e saj. Pastëri i bëri gjilpëra djalit për 10 ditë, dhe djali jetoi.

Disa dekada më vonë, nga të gjitha gjërat që Lui Pastër mund të kishte kërkuar që të shkruheshin mbi gurin e tij të varrit, ai kërkoi të shkruheshin vetëm këto tri fjalë: Joseph Meister jetoi. Këto fjalë i japin formë trashëgimisë së kishës së gjallë të Krishtit. Njerëzit do të jetojnë përjetësisht për shkak të investimit tonë në misionin e Krishtit. Thirrja jonë nuk është që të përqendrohemi tek

vetja apo të luajmë sipas preferencave të njerëzve të cilët mendojnë më shumë si konsumatorë frymërorë se sa si shërbëtarë shërbyes. Thirrja jonë është të shpallim ungjillin dhe të mobilizojmë kishën e Krishtit për të bërë gjithçka që është e mundur për të arritur njerëzit e humbur nga pikëpamja frymërore.

Pastori i njohur misionar nga Kanadaja, Oswald J. Smith, shkroi në librin e tij, “*Britma e Botës*”: “Ne duhet të kishim mbajtur para vetes urdhërimet e pas-Ringjalljes së Zotit tonë. Duhej të kishim ungjillizuar botën. Përndryshe nuk kemi asnjë bazë për ekzistencën tonë si një kishë. Nuk ka asnjë arsye se përse duhet të kemi kisha përveçse atëherë kur ato janë duke ungjillizuar ata të cilët nuk kanë dëgjuar asnjëherë.”

Ndryshimi është i vështirë në shumicën e kishave tona, dhe ndryshimi për hir të ndryshimit është një ushtrim i padobishëm. Por ndryshimi i cili është i motivuar dhe i domosdoshëm nga misioni ynë për të arritur me efikasitet njerëzit, është një ndryshim nga i cili nuk duhet t'i humbasim kurrë shpresat. Udhëheqësit për misionet zgjidhin probleme në mënyrë të guximshme dhe heqin pengesat ndaj arritjes së njerëzve të humbur dhe të lënduar. Udhëheqësit për misionin kërkojnë rezultate pa pushim dhe gjejnë mënyra për t'i bërë gjërat. Udhëheqësit për misionin nuk strehohen kurrë tek e parashikueshmja apo tek e njohura apo tek ajo që është e sigurt. Jezusi tha: “Shkoni”, prandaj edhe ata nuk “ulen”.

Fryma e Perëndisë po lëviz, dhe përmes njerëzve të fuqizuar nga Fryma dhe të cilët mendojnë për misionin, Jezusi akoma vazhdon të mbajë premtimin e tij që bëri para 2000 vjetësh: “Do të ndërtoj kishën time.”

Thelbësore ndaj kësaj të ardhmeje do të jetë një brez i udhëheqësve të fuqizuar të cilët Perëndia do t'i ngrejë lart. Këta do të jenë udhëheqësit sipas stilit të Jezusit, udhëheqësit e përlurur, udhëheqësit pentekostalë të cilët janë frymërorë në mënyrë të mirëfilltë, të dhënë pas marrëdhënieve në mënyrë personale dhe të dhënë pas misionit në mënyrë aktive. Ia dorëzofshim veten tonë këtyre qëllimeve dhe e përkushtofshim veten tonë për t'u bërë udhëheqës pentekostalë të cilët shërbejnë dhe mentorojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse në fuqinë e Frymës, duke i dhënë formë një të ardhmeje të përkushtuar ndaj lavdisë së Perëndisë dhe ndaj ndërtimit të kishës së Krishtit.



JAMES T. BRADFORD, Ph.D.,
sekretar i përgjithshëm për
Këshillin e Përgjithshëm të
Asambleve të Perëndisë,
Springfilld, Misuri.

"Kini në vetvete po atë qëndrim që ishte
në Jezu Krishtin."

~ Filipianëve 2:5

ÇFARË LLOJ QËNDRIMI KENI?

Nga: Marcia Lednicky

"Perëndia i bekon ata që janë skamës në frymë dhe që kuptojnë se ia kanë
nevojën Atij, sepse mbretëria e qiejve i takon atyre.

Perëndia i bekon ata që vajojnë, sepse ata do të ngushëllohen.

Perëndia i bekon ata që janë të përlur, sepse ata do ta trashëgojnë të gjithë tokën.

Perëndia i bekon ata që janë të uritur dhe të etur për drejtësi, sepse ata do të jenë të
kënaqur.

Perëndia i bekon ata që janë të mëshirshëm, sepse atyre do t'iu jepet mëshirë.

Perëndia i bekon ata që i kanë zemrat të pastra, sepse ata do ta shohin Perëndinë.

Perëndia i bekon ata që punojnë për paqen, sepse ata do të quhen bij të Perëndisë.

Perëndia i bekon ata që janë të përndjekur ngaqë bëjnë atë që është e drejtë,
sepse Atyre iu përket mbretëria e qiejve.

Perëndia ju bekon kur ju fyejnë dhe ju përndjekin dhe, gënjejnë e thonë çdo lloj fjale të keqe
kundër jush, për shkakun se jeni ndjekësit e mi.

Gëzohuni për këtë! Ngazëllehuni! Sepse një shpërblim i madh ju pret në qiej."

Mateu 5:3-12*

(* nga versioni "New Living Translation" i përkthimit në anglisht të Biblës)

A person's silhouette is visible on the left side of the page, with their arms raised towards a bright, hazy sunset sky. The sky transitions from a deep orange near the horizon to a darker, more muted blue and green at the top. The overall mood is one of hope and aspiration.

QËNDRIMI ynë luan një rol të madh në mënyrën sesi i përqasemi rrethanave të jetës së përditshme. Fjalja e fundit e këtij fragmenti të njohur nga Shkrimi e përmbledh esencën e asaj që dëshiroj të komunikoj në këtë numër të revistës. Tek Mateu 5:12 thuhet:

“GËZOHUNI PËR KËTË! NGAZËLLEHUNI! SEPSE NJË SHPËRBLIM I MADH JU PRET NË QIEJ”.

QËNDRIMI im do të ndikojë në aftësitë e mia për të shërbyer, dhe, ç’është akoma më e rëndësishme, do të ndikojë në mënyrë dramatike marrëdhënien time personale me Perëndinë.

"Sa më shumë jetoj, aq më shumë e kuptoj ndikimin e qëndrimit mbi jetën. Për mua, qëndrimi është më i rëndësishëm sesa faktet. Është më i rëndësishëm se e kaluara; se arsimi, se paratë, se rrethanat, se dështimet, se sukseset, se ajo që njerëzit e tjerë mendojnë apo thonë apo bëjnë. Është më i rëndësishëm se pamja e jashtme, dhuntitë apo aftësitë. Qëndrimi ose do e ngrejë ose do e ulë një kompani ... një kishë ... një shtëpi. Gjëja më e mrekullueshme është që ne kemi një zgjedhje çdo ditë për sa i përket qëndrimit që do të mbajmë atë ditë. Nuk mund ta ndryshojmë të kaluarën tonë ... nuk mund ta ndryshojmë faktin që njerëzit do të veprojnë në një mënyrë të caktuar. Nuk mund ta ndryshojmë të pashmangshmen. E vetmja gjë që mund të bëjmë është të luajmë me të vetmen gjë që kemi, dhe ky është qëndrimi ynë.... Unë jam i bindur që jeta është 10% çfarë më ndodh mua dhe 90% mënyra si reagoj unë ndaj saj. Dhe po kështu është edhe me ju...

Ne jemi përgjegjës për qëndrimet tona."

Nga CHARLES SWINDOLL

Unë vendos se çfarë lloj qëndrimi do të kem për çdo ditë.

❖ **Unë vendos që do të dua** edhe nëse lëndohem. Dhe ndonjëherë kjo është pikërisht ajo që ndodh. Në shërbesë ju luteni me njerëzit, punoni me njerëzit dhe investoni shumë nga koha juaj dhe energjitë tuaja në mirëqenien e tyre frymërore. Nganjëherë ata do të largohen nga dashuria e Perëndisë dhe madje edhe mund të bëjnë ose të thonë gjëra që do t'ju lëndojnë, ose që janë kundër jush. Por, për shkak të dashurisë së Krishtit brenda meje, dhe për shkak të bindjes sime ndaj Fjalës së Tij, unë vazhdoj që të dua. Përse? Fjala e Perëndisë na tregon që kushdo mund t'i dojë ata të cilët i duan. Por Shkrimi na këshillon që të bëjmë edhe më shumë.

Tek Mateu 5:46-47, Zoti ynë thotë:

“Sepse, po të doni vetëm ata që ju duan, çfarë shpërblimi do të kenë? Dhe nëse përshëndetni vetëm vëllezërit tuaj, çfarë bëni të veçantë?” Kur unë jam i mbushur me dashurinë e Jezusit, marrja e vendimit për të dashur edhe ata veprat e të cilëve janë të dhimbshme nuk është e vështirë sepse në zemrën time ekziston një vërvshim i dashurisë së Krishtit. Mbani mend që Jezusi i tregoi dashurinë e Tij Juda Iskariotit edhe kur Juda e tradhtoi Atë me një puthje.

❖ **Unë vendos që do të jem i/e lumtur** edhe kur rrethanat e mia janë shumë ndryshe nga si do të dëshiroja të ishin. Në fund të fundit, unë duhet të mbaj mend që lumturia e vërtetë është e ndërtuar mbi marrëdhënien time me Jezus Krishtin dhe askush nuk mund ta marrë gëzimin dhe paqen e Tij prej meje. Kështu, unë vendos të jem i/e lumtur, duke u ngritur mbi çdo rrethanë të vështirë. *“Gëzohuni gjithnjë në Zotin; po jua them përsëri: Gëzohuni!”* (Filipianëve 4:4). Në një botë të vërtetë, të mbushur me ligësi, Perëndia nuk premton që nuk do të ketë kurrë asnjë problem. Ai në fakt premton që do të jetë gjithmonë me mua. Ai e di saktësisht se ku jam dhe se çfarë jam duke kaluar në çdo moment të caktuar. Fjala e Tij na jep sigurinë që Ai nuk do të lejojë kurrë më shumë nga sa mund të mbajmë. Perëndisë i qoftë lavdia për këtë forcë dhe hir të mahnitshëm.

❖ **Unë vendos që do të kem një qëndrim pozitiv.** Tek Filipianëve 4:8, Apostulli Pal thotë: *“Të gjitha gjërat që janë të vërteta, të gjitha gjërat që janë të ndershme, të gjitha gjërat që janë të drejta, të gjitha gjërat që janë të pastra, të gjitha gjërat që janë të dashura, të gjitha gjërat që janë me famë të mirë, nëse ka ndonjë virtut dhe nëse ka ndonjë lëvdim, këto mendoni.”* Njerëzit pozitivë tërheqin njerëz të tjerë tek vetja, ndërkohë që një frymë negative i zmbars njerëzit. Si besimtarë fitues nga aspekti frymëror, duhet të jetë dëshira jonë që njerëzit të ndihen më mirë pasi të kenë qenë në praninë tonë. Objektivi ynë frymëror duhet të jetë që një individ pasi të ketë kaluar kohë me ne të ndihet i dashur, i inkurajuar dhe i bekuar.

Unë jam një fëmijë i rritur në shtëpinë e një shërbestari, dhe si i tillë, më kanë mësuar rëndësinë e të pasurit të një qëndrimi të duhur karshi të tjerëve. Prindërit e mi më thoshin: “E mira ekziston tek të gjithë; kërko të mirën, Perëndia pastaj do të kujdeset për pjesën tjetër”. Ndërsa ata e modeluan këtë gjë në sytë e mi, shumë shpejt unë kuptova që njerëzit reagueshan dhe i deshën ata si një kundërpërgjigje ndaj sjelljes së tyre. Nuk mund ta them se sa shumë herë më ka ndihmuar ky udhëzim nga fëmijëria në situata të vështira, ose me individë të vështirë. Po, që të gjithë jemi ndeshur me individë që nuk janë edhe aq të përsosur, por me ndihmën e Frymës së Shenjtë brenda nesh, ne mund të kemi një qëndrim të duhur.

❖ **Unë vendos që do të kem një qëndrim falënderues.** Ka aq shumë për të cilën mund të jemi dhe duhet të jemi falënderues. Përpikuni çdo ditë ta bëni zakon që

të numëroni bekimet tuaja. Veçanërisht të jemi falënderues që dikush na prezantoi me Jezusin dhe tani ne kemi privilegjin që ta ndajmë mesazhin e shpresës me të tjerët. Të jesh i zgjedhur për të qenë një zëdhënës për Jezusin, me fjalë dhe me vepra, është thirrja më e madhe që mund të ketë dikush në këtë jetë. Pranojeni këtë pozicion të dhënë nga Perëndia si një sfidë, në vend që ta pranoni si detyrë. Mbani mend, Ai nuk do të kërkojë asnjëherë që të bësh diçka të cilën Ai nuk do të ishte i gatshëm ta bënte për ty. Krishti e vërtetoi dashurinë e Tij kur Ai erdhi në këtë tokë dhe vdiq në kryq për mëkatet tona. Jini falënderues që keni një shtëpi, një familje, dhe, më e rëndësishmja, një Perëndi personal i cili ju do. Jemi vërtetë të bekuar.

❖ **Unë vendos që nuk do të jem në pozita mbrojtëse.** Një ose dy përvoja të këqija mund të shkaktojnë që të ndodhë pikërisht kjo gjë me ne dhe shumë shpejt mund të fillojmë të ndiejmë që kushdo ka diçka kundër nesh. Kjo gjë do të prodhojë gjithmonë ndjenja negative karshi të tjerëve, dhe madje në frymërat tona mund të zhvillohet edhe mëria. Askush prej nesh nuk është i përsosur dhe duhet të vlerësojmë me ndershmëri çdo kritikë. Ndoshta ai person po përdoret nga Zoti për të na treguar një fushë në jetën tonë e cila ka nevojë të kalojë nën kontrollin e Tij.

❖ **Unë vendos që nuk do të kem një frymë paragjyquese.** Mbani mend, unë do të gjykojem sipas gjykimit me të cilin gjykoj unë vetë. Është thënë: “Mos u zemëroni që nuk mund t’i bëni të tjerët ashtu si dëshironi që ata të jenë, duke qenë që nuk mund ta bëni veten ashtu si dëshironi të jeni”. Unë duhet ta dua mëkatërin, ndërkohë që duhet ta refuzoj mëkatën. Shpeshherë kjo është një sfidë e jashtëzakonshme; megjithatë Fryma e Shenjtë do të na ndihmojë të mbajmë një zemër të butë karshi atyre individëve të cilët nuk e kanë pranuar Krishtin ose të cilët nuk janë të pjekur nga ana frymërore.

❖ **Unë vendos që nuk do të jem kritikues.** Një frymë kritikuese do të më nxehë dhe më në fund do të më shkatërrojë. Xhorxh Bernard Shou (George Bernard Shaw) ka thënë: “Më mirë mbajeni veten të pastër dhe të kthjellët, sepse ju jeni dritarja përmes së cilës e shikoni botën.” Jini të kujdesshëm duke e shmangur një qëndrim të hidhur e kritikues karshi anëtarëve të bashkësisë, drejtuesve të kishës apo bordit të pleqve. Kuptojeni mirë që duhet t’i mbani mendimet dhe fjalët tuaja nën kontroll të kujdesshëm. Një person mund të zhvillojë me lehtësi një zakon shumë të keq për të qenë kritikues. Thjesht refuzoni të gjeni faj tek të tjerët apo të flisni gjëra të këqija

ndaj të tjerëve. Jini të shpejtë për të lavdëruar në vend që të mallkoni. Një varg nga Shkrimi të cilin e citoj shpeshherë është: “U miratofshin para teje fjalët e gojës sime dhe përsiatjet e zemrës sime, o Zot, kështjella ime dhe shpengimtari im.” (Psa 19:14).

Ruaní qëndrimin tuaj

Ndërsa **mbajmë vazhdimisht një sy mbi qëndrimin tonë**, kur dallojmë që armiku po kërkon çdo mënyrë për të sjellë shkurajim apo disfata në jetët tona, atëherë, me parapritje të madhe, është shumë e lehtë t’i besojmë Perëndisë për gjëra edhe më të mëdha në jetët tona. Sa emocionuese është kur kuptojmë se Ai dëshiron të punojë përmes secilit prej nesh si mjeti i Tij. Mendoni se çfarë do të thotë për të tjerët kur ne përhapim gëzim të perëndishëm, kur jemi një zë inkurajimi, për të shfaqur paqen që vjen duke i shërbyer Jezusit. Përmes hirit të mahnitshëm të Perëndisë, mos lejoni që litari shpëtues i dashurisë së Tij shpenguese të pritët nga një qëndrim i keq. Përkundrazi, zgjidhni një qëndrim pozitiv nga ana frymërore për çdo ditë. Po, është e vërtetë që do të na duhet ta përshtatim shpesh qëndrimin tonë. Kuptoni që ky “qëndrim” është më shumë sesa një lloj i caktuar personaliteti; është të jetuarit në dritën e hirit të Tij dhe të ecurit në Frymë. Vazhdoni të rriteni. Lejoni Frymën e Shenjtë t’ju zhvillojë në imazhin e Krishtit. Qëndrimi juaj do t’i sjellë lavdi Emrit të Tij.

Me ndihmën e Perëndisë, qëndrimi ynë i udhëhequr nga Fryma do t’i sfidojë të tjerët për të pasur një pamje më të qartë të asaj se kush është Ai. Do t’i jepni familjes suaj dhe personave përreth jush një nga dhuratat më të mëdha në këtë jetë ndërsa, me anë të shembullit, portretizoni fitimet e një qëndrimi të mirë e të perëndishëm. Edhe pse prindërit e mi tani janë me Zotin, unë do të jem përherë mirënjohëse që me anë të fjalëve të tyre dhe me anë të jetëve të përditshme jam aftësuar që gjithmonë të kërkoj për anën pozitive tek secili person dhe në çdo situatë.



MARCIA LEDNICKÝ është një folëse në takime, konferenca dhe seminare për gratë. Ajo ka një aftësi unike për të lidhur sfidat e jetës së përditshme me të vërtetat biblike. Shërbesa e saj si folëse pasurohet edhe nga talenti i saj vokal me anë të të cilit ajo komunikon dashurinë e Krishtit.



Ftesa e Altarit:

TËRHEQJA e RRJETËS

Nga: H. Maurice Lednicky

***“Të Tërheqësh Rrjetën”* është një shprehje e zakonshme e përdorur midis predikuesve pentekostalë, dhe i referohet ftesës së altarit ose reagimit publik ndaj një predikimi. Origjina e saj rrjedh nga pjesa në Shkrim ku disa peshkatarë zunë mrekullisht një sasi të madhe peshqish në rrjetat e tyre, dhe Jezusi i thirri ata të bëheshin “peshkatarë njerëzish”.**



ë gjithë peshkatarët e zotë e dinë që peshku quhet i kapur vetëm kur është në varkë. Dhe kjo është diçka e një rëndësie të veçantë. Në po atë moment që Fryma e Shenjtë jep një Fjalë të ndriçuar përmes predikimit, mundësia për të bërë thirrje për veprim është në nivelin e saj më të lartë.

Shpesh ajo që ndodh këtu përcakton rritjen e ardhshme të farës së mbjellë. Në mënyrë të mahnitshme, i njëjti mesazh shkakton një ndjenjë reaguese për një shumicë individësh të cilët kanë personalitete të veçanta dhe një gamë të gjerë rrethanash. Me siguri, kjo është puna e mbinatyrshme e Frymës.



Përgjatë pothuajse 50 viteve në udhëtim me shërbesën, kam pyetur shumë pastorë se sa shpesh kanë ofruar ata një ftesë altari. Për kishat të cilat janë duke përjetuar rizgjim të vazhdueshëm dhe kishat të cilat shohin të konvertuar të rinj në mënyrë të rregullt, pa përjashtim përgjigjja është: “në çdo shërbesë”. Njerëzit po reagojnë ndaj predikimit të Fjalës së Perëndisë kur u jepet një mundësi për ta bërë këtë.

Disa pastorë/predikues mund të mos e ofrojnë ftesën nga frika se askush nuk do të reagojë. Shqetësime të tilla duhet të lihen mënjanë. Më mirë një mundësi e dhënë dhe pa asnjë reagim sesa të anashkalohet qoftë edhe një fëmijë i vogël, zemra e të cilit është zbutur nga ana e Frymës dhe është gati për të reaguar.

Predikuesi duhet ta planifikojë ftesën duke qëndruar në lutje dhe ta konsiderojë atë një pjesë integrale të mesazhit. Kjo gjë nuk vendos aspak kufizime në punën sovranë të Frymës së Shenjtë ndërsa shërbestari vazhdon të jetë i ndjeshëm ndaj udhëheqjes së Frymës. Nëse nuk ka hapësira kohore në dispozicion (p.sh., dy ose më shumë shërbesa të dielave në mëngjes), kohëzgjatja e

veçuar për predikimin duhet të jetë e mjaftueshme në mënyrë që të përfshijë një reagim të përshtatshëm nga bashkësia.

Gjithashtu, duhet të ketë udhëzim të shpeshtë (predikim/mësim) mbi prioritetin për të takuar Perëndinë tek altari. Kjo, jo vetëm që ndërton besim dhe siguri në fuqinë e Perëndisë, por gjithashtu shërben si një kujtesë ndaj varësisë sonë të plotë tek Ai në çdo situatë të jetës.

Jo të gjitha reagimet e dëshiruara janë identike – ato mund të kategorizohen në të *menjëhershme* dhe *afatgjata*. Sigurisht, e gjithë puna e Frymës së Shenjtë është jetë-ndryshuese dhe përfundimisht ka një ndikim *afatgjatë* tek besimtari. Megjithatë, kategoria e *menjëhershme* nënkupton një reagim publik për shpëtim, shërim hyjnor, pagëzim në Frymën e Shenjtë ose për nevoja të tjera për të cilat, ndërkohë që mund të jeni tek altari, mund të ndodhë një vepër e hirit hyjnor. Ndërsa ato përkushtime të cilat kërkojnë veprime shtesë dhe/ose veprime të vazhdueshme (p.sh., pajtim, ripërtëritje të marrëdhënieve, lutje të disiplinuar, të qenët një dëshmitar për Krishtin), mund t'i përshtaten përshkrimit për kategorinë *afatgjatë*.

JI I PËRGATITUR NGA ANA FRYMËRORE

Prezantimi publik bëhet i vlefshëm nga përgatitja vetjake. A e kemi përsëritur domosdoshmërinë e përgatitjes frymërore aq shpesh sa që i japim asaj vetëm një kohë të shkurtër përpara se të kalojmë tek shqetësimet e tjera? Ky është kushti thelbësor për shërbesë efikase në çdo nivel. Në librin e tij klasik, "Power Through Prayer" (Fuqi Përmes Lutjes), I Em Bounds (E.M. Bounds) thotë: "Predikuesit të cilët përftojnë rezultate të mëdha për Perëndinë janë ata njerëz të cilët kanë triumfuar në përgjërimit e tyre me Perëndinë përpara se të provonin të përgjëroheshin me njerëzit. Predikuesit të cilët janë më të fuqishmit në marrëdhënien e tyre personale me Perëndinë janë më të fuqishmit në foltoret e tyre me njerëzit."

JI I ZJARRTË NË THIRRJE

Prokurorët, politikanët, avokatët e një kauze janë më efikasë nëse ata janë të zjarrtë në prezantimet e tyre. Çështja e humbjes së njerëzimit nuk është një rast "ja-merre-ja-lëre". Fatet e përjetshme varen nga vendimi i zgjedhjes së parajsës apo të ferrit. Nëse ungjilli është i vërtetë – dhe qartësisht është i tillë - atëherë mesazhi i shpengimit, shpresës, çlirimit, shërimit, rimëkëmbjes dhe premtimet e tjera të panumërta të së tashmes dhe të së ardhmes, nuk ka nevojë për asnjë apologji. Ji i sigurt. Atëherë dhe vetëm atëherë mund të bindësh dhe të tjerët.

MOS JI I SHPËRQENDRUAR

Koha, njoftimet dhe aktivitete të tjera të planifikuara (sado të vlefshme që mund të jenë) shpeshherë përplasen me ftesën e altarit. Një ftesë e dhënë me nxitim dhe në të njëjtën kohë shpërndarja e bashkësisë nga ana e drejtuesit të shërbesës iu dërgon një sinjal të fortë atyre që thirren nga Fryma e Shenjtë për të shkuar te altari. Njerëzit do ta interpretojnë këtë si një ftesë që nuk ka rëndësi.

Mos i jep ftesës së altarit më pak vlerë nga sa i takon. Modifiko gjërat e tjera. Një pjesë e kohës së adhurimit mund të bëhet shërbesë e dobishme rreth altarit menjëherë pas mesazhit dhe ftesës. Predikimi i Fjalës së Perëndisë dhe zbatimi personal i saj nga Fryma duhet të jetë prioriteti kryesor i çdo shërbesë adhurimi. Një kohë e menjëhershme gjatë së cilës bashkësia është në pritje të Perëndisë, bën të mundur që ftesa e altarit të ndodhë në një moment shumë të volitshëm.

JI SPECIFIK

Nëse predikon një mesazh ungjillizues, fokusojë ftesën tënde te mëkatarët. E njëjta taktikë është e vërtetë për pagëzimin me Frymën e Shenjtë apo për shërimin hyjnor. Por pasja e një thirrjeje specifike duhet të jetë gjithashtu e vërtetë kur predikohet rreth martesës apo marrëdhënieve në familje, rreth të dhjetës, rreth një thirrjeje për shërbesë apo mision apo rreth unitetit në bashkësinë vendore.

Unë preferoj t'iu kërkoj njerëzve që të afrohen për lutje. Patjetër që qëllimi nuk është aspak për të vënë ndonjë person në siklet, por përkundrazi është një rrëfim publik i nevojës së secilit prej nesh. Deri në kohën kur një person të jetë i gatshëm që të qartësojë se pa ndërhyrjen hyjnore ai është i paafte që të korrigjojë natyrën e tij të prishur, ka shumë pak gjasa që ai ose ajo të përjetojë ndonjëherë çlirim frymëror dhe fitore.

PËRDOR NJË SHUMËLLOJSHMËRI METODASH

Si pentekostalë, ne krenohemi me informalitetin tonë, por madje ajo që mund të klasifikohet si përqasje jo-liturgjike mund të bëhet shumë formale. Përqasja: "Ulini kokat, mbyllini sytë, ngrini duart lart, qëndroni në këmbë, afrohuni" nuk duhet të jetë përqasja jonë e vetme gjatë kohëve të lutjes. Kjo përqasje është e vlefshme, por metodat e tjera mund të jenë gjithashtu efikase. Lejo Frymën e Shenjtë që të të përdorë në mënyrë krijuese. E them përsëri, planifiko ftesën si një pjesë të mesazhit. Lutu pa pushim për të. Mendoje mirë. Fryma me siguri mund të ta udhëheqë zemrën paraprakisht.

KI PUNËTORË ALTARI TË TRAJNUAR DHE TË PËRGATITUR

Është shkurajuese për zemrën të shohësh kaq shumë kisha në kombin tonë që nuk kanë punëtorë të trajnuar për shërbesën në altar. Shpeshherë më duhet të pyes që dikush të vijë edhe të lutet me ata të cilët i janë përgjigjur thirrjes së altarit. Përfitimet e përjetshme të të pasurit



punëtorë të përgatitur nga ana e Shkrimit dhe të ndjeshëm në Frymë mund të jenë kolosale. Udhëzimi personal dhe individual ndaj kërkuarës do të japë përgjigje për pyetjet dhe do të çojë në një kuptim të së vërtetës e cila mund të mos ketë qenë e kuptuar më parë.



PËRDOR MUZIKANTË QË JANË VIGJILENTË NGA ANA FRYMËRORE

Sociologët kanë arritur prej shumë kohësh në përfundimin se filozofia e një kulture shprehet më qartësisht përmes muzikës së saj. Për besimtarët fryma e brendshme shprehet përmes këngëve dhe himneve frymërore. Modeli është i artikuluar vazhdimisht në Shkrim. Muzika ishte një pjesë integrale e adhurimit dhe e lavdërimit.

Muzikantët e vajosur të cilët shërbejnë në harmoni me Frymën mund ta rrisin shumë shërbesën e altarit. Përgatiti ata përmes lutjes në unitet. Këshilloji për temën e mesazhit. Në disa situata planifiko këngë ose refrene specifike në mënyrë që të mos ketë pauza në muzikë ndërsa ata janë duke kërkuar si të çmendur për një këngë të përshtatshme. Konsideroju muzikantët si një shtesë që i bëhet mesazhit.

NDIQ UDHËHEQJEN E FRYMËS

Kjo është shumë e ngjashme me të qenit të përgatitur nga ana frymërore. Të jesh personalisht në të njëjtin drejtim me Frymën nuk është diçka që ndodh aksidentalisht. Në përvojën time, e cila lidhet shpesh me një bashkësi për të cilën unë nuk di asgjë, e kam kapur mendjen time teksa udhëhiqej drejt adresimit të çështjeve specifike, të cilat janë përtej fushës së çdo informacioni të mëparshëm. Kjo gjë ka një ndikim të fuqishëm si mbi besimtarët, ashtu edhe mbi jo besimtarët. Besimi rritet.

Mëso të dëgjosh zërin e Frymës dhe ndiqe atë në mënyrë të përlulur dhe me nderim.



SHËRBEJU PERSONALISHT ATYRE QË REAGOJNË/PËRGJIGJEN

Kjo nuk e zvogëlon shërbesën e punëtorëve të tjerë të altarit. Dhe as nuk e shquan (ose veçon) konceptin mbi udhëheqësinë e një interpretuesi/audience. Përkundrazi, ajo shpreh një besim që buron nga një zemër e dhembshur plot përkujdesje. Të përshëndesësh njerëzit ndërsa largohen nga kisha është diçka me vlerë; megjithatë, nëse duhet të bëhet një zgjedhje, jepi përparësi shërbesës ndaj të lënduarve që vijnë te altari.

JEP MUNDËSI PËR DËSHMI PUBLIKE

Shërbesa e dëshmime, siç bëhej më parë, ka rënë në kohë të vështira – ndoshta, në disa situata, me të drejtë. Por përsëri, me anë të vajosjes së Frymës, ji krijues. Pyet disa njerëz paraprakisht për të dëshmuar (bazuar mbi njohjen individuale apo mbi informacionin nga një prej punëtorëve të altarit). Qëndro në këmbë me personin. Mbaj mikrofonin. Drejto pyetje për ta mbajtur folësin të fokusuar tek tema. Sa inkurajim që është të dëgjosh se si Perëndia ndërhyr në rrethanat njerëzore!

Ftesa e altarit nuk është një mendim që vjen pas shërbesës apo një shtesë programi në përmbylljen e shërbesës. Pasi është predikuar Fjala, Fryma e Shenjtë ka ndriçuar të vërtetën dhe i ka bindur dëgjuesit. Predikuesi duhet të tërheqë rrjetën.



Dr. H. MAURICE LEDNICKÝ,

ka qenë një shërbyes i shuguruar me Asamblëtë e Perëndisë për 50 vjet. Ai është autor, ungjilltar, pastor, misionar, dhe ish-president i shkollës Central Bible College, Springfield, Missouri.

*Pak
Para
Ofertës...*



TË MBJELLËSH dhe TË KORRËSH

Dhuratat e tua do të jenë një bekim për shumë veta. Por, më tepër se kaq, ajo që ti jep gjithashtu është përfitim për ty. Ti pyet: “Si mund të jetë përfitim për jetën time ajo që jap unë?”

Të dhënit na bën më shumë të ngjashëm me Perëndinë, na afron më pranë Perëndisë, na jep një kundërhelm ndaj materializmit, e forcon besimin tonë dhe bën një investim në përjetësi. Por, të dhënit gjithashtu, në këmbim, na bekon edhe neve.

Tek Fjalët e Urta 11:25 deklarohet: “Njeriu bujar do të pasurohet dhe ai që ujitet gjithashtu.” Çfarëdo që jep, do të ta kthejnë përsëri. Nëse je bujar me kritika, do të

marrësh shumë kritika. Nëse je bujar me thashetheme, do të marrësh thashetheme. Nëse je bujar me inkurajime, do të marrësh inkurajime. Ky është ligji i asaj që çfarë mbjell, edhe do të korrësh. Nëse je bujar me paratë e tua, edhe ti do të marrësh para. Ky është një ligj i jetës. “Njeriu bujar do të pasurohet. Ai që ujit do të ujitet gjithashtu.”

Prandaj, të inkurajoj që ta shijosh përfitimin e të dhënit – duke besuar që ndërsa jep Perëndia do të të bekojë ty në këmbim të kësaj.

Nga: **GLENN REYNOLDS**
Hampton, Virginia

Cili është qëndrimi dhe zgjedhja e duhur?

Nga: Pastor Miljard Gosturani

Mateu 6:19-34

"Mos mblidhni për vete thesare mbi tokë, ku i brejnë tenja dhe ndryshku, dhe ku vjedhësit shpërthejnë dhe vjedhin, përkundrazi mblidhni për vete thesare në qiell, ku as tenja as ndryshku nuk prishin dhe ku vjedhësit nuk shpërthejnë dhe nuk vjedhin. Sepse ku është thesari juaj do të jetë edhe zemra juaj. Drita e trupit është syri; në qoftë se syri yt është i pastër, gjithë trupi yt do të jetë i ndriçuar, por në qoftë se syri yt është i lig, gjithë trupi yt do të jetë në errësirë; në qoftë se drita, pra, që është në ty është errësirë, sa e madhe do të jetë errësira!

Askush nuk mund t' u shërbejë dy zotërinjve, sepse ose do të urrejë njërin dhe do ta dojë tjetrin; ose do t' i qëndrojë besnik njerit dhe do të përçmojë tjetrin; ju nuk mund t' i shërbeni Perëndisë dhe mamonit. Prandaj po ju them: mos u shqetësoni për jetën tuaj, për atë që do të hani ose do të pini, as për trupin tuaj, për atë që do të vishni. A nuk është vallë jeta më me vlerë se ushqimi dhe trupi më me vlerë se veshja?

Vini re zogjtë e qiellit: ata nuk mbjellin, nuk korrin dhe nuk mbledhin në hambare; megjithatë Ati juaj qiellor i ushqen. A nuk vleni ju shumë më tepër se sa ata? Dhe cili nga ju, me gjithë kujdesin e tij, mund t' i shtojë shtatit të tij qoftë edhe një kubit të vetëm? Pse shqetësoheni për veshjen tuaj? Vini re si rriten zambakët e fushës: ata nuk lodhen dhe nuk tjerren; dhe unë, pra, po ju them se Salomoni vetë, me gjithë lavdinë e tij, nuk ishte veshur si ndonjë nga ata. Tani nëse Perëndia e vesh kështu barin e fushës, që sot është dhe nesër hidhet në furrë, vallë nuk do t' ju veshë shumë më tepër ju, njerëz besimpakë?

Mos u shqetësoni, pra duke thënë: "Çfarë do të hamë ose çfarë do të pimë, ose me çfarë do të vishemi?". Sepse janë paganët ata që kërkojnë të gjitha këto gjëra; Ati juaj qiellor, pra, e di mirë se ju keni nevojë për të gjitha këto gjëra. Por para së gjithash kërkon mbretërinë e Perëndisë dhe drejtësinë e tij dhe të gjitha këto gjëra do t' ju shtohen. Mos u brengosni, pra, për të nesërmen, sepse e nesërmeja do të kujdeset vetë për vete. Secilës ditë i mjafton pikëllimi i vet."

Hyrja:

Jezusi e dha këtë mësim në Predikimin në Mal. Shumë studiues janë të mendimit se Predikimi në Mal përbën thelbin dhe esencën e gjithë mësimit të Jezus Krishtit, bazë në të cilën hidhen themelet dhe ndërtohet e gjithë doktrina e krishterë. Dhe në këtë pasazh, Jezusi, Zoti dhe mësuesi ynë i madh, na mëson se si ne kemi nevojë që të mbajmë qëndrimin dhe të bëjmë zgjedhjen e duhur, jo vetëm në momentin e parë kur bëjmë rrëfimin e mirë të besimit në Krishtin, por në jetën tonë të përditshme, në zgjedhjet që ne bëjmë në çdo çast.

Përvijimi:

I. Cili është thesari i vërtetë (v. 19-21)

- Thesari që nuk duhet mbledhur kurrë, v. 19
- Thesari i pavërtetë është i pasigurt, v. 19
- Thesari që duhet mbledhur, v. 20; Mat. 25:34-40; Jak. 1:27
- Thesari ynë tregohet nga synimet e zemrës sonë, v. 21

II. Cili është Zotëria Ynë (v. 24)

- Zotërinjtë që kërkojnë shërbimin tonë
- Ne kemi nevojë që të zgjedhim zotërinë tonë
- Ndryshimi mes dy zotërinjve
- Pamundësia për t' i shërbyer dy zotërinjve në të njëjtën kohë

Përfundimi:

Vëllezër dhe motra në Krishtin, të gjitha këto paralelizma dhe kontraste të vendosura në mesazhin e mësimit të Jezus Krishtit janë dilemat dhe barrierat e mëdha me të cilat ne si dishepuj të Jezus Krishtit përballemi çdo ditë. Ne kemi bërë rrëfimin e mirë të besimit dhe kemi hedhur hapin e parë, dhe disa prej nesh kemi bërë edhe disa hapa përpara. Le të mos ndalojmë në marshimin tonë drejt Jezus Krishtit dhe zgjerimit të mbretërisë së Perëndisë në tokë sepse shpërblimi do të jetë i madh në tokë dhe në qiell.

III. Cili duhet të jetë qëndrimi ynë kur jemi në nevojë (v. 25-32)

- Të mos shqetësohemi për gjërat, v. 25, 31
- Të vlerësojmë jetën dhe vlerën që kemi në Zotin, v. 25b, 26b, 30b
- Të inkurajohemi nga kujdesi i Perëndisë për ne, v. 26, 28, 30a
- Të kuptojmë që të shqetësuarit nuk sjell dobi, v. 27
- Të kuptojmë që të ankuarit është shenjë mosbesimi në Zotin, v. 31, 32a
- Të besojmë që Perëndia vetë do t' i plotësojë nevojat tona, v. 32b

IV. Cili duhet të jetë shqetësimi ynë (v. 33-34)

- Shqetësimi ynë duhet të jetë mbretëria e Perëndisë--shpëtimi dhe lavdia e Tij, v. 33
- Shqetësimi ynë duhet të jetë drejtësia e Tij--ecja në shenjtëri të përditshme, v. 33
- Kur shqetësohemi për punën e Perëndisë, Ai shqetësohet për punën tonë, v. 33



MATERIALE DISHEPULLIZIMI DHE TRAINIMI

në dispozicion për kishën tuaj

nga



UNIVERSITETI GLOBAL

Programi i Dishepullizimit (Seritë mbi Jetën e Krishterë)

Cili është hapi tjetër mbasi një person ka pranuar Jezus Krishtin si Shpëtimtar? Ai duhet të dishepullizohet dhe të mësojë mënyrën e krishterë të të jetuarit. 18 kurset e serisë mbi Jetën e Krishterë shtrojnë themelin e besimit për besimtarin e ri.

Zhvillimi Devocional

- Kur Ju Luteni
- Si ta Studiojmë Biblën
- Miku Juaj Ndihmues
- Adhurimi i Krishterë

Zhvillimi Doktrinor

- Jeta Juaj e Re
- Bibla Juaj
- Ungjilli i Gjonit
- Kush Është Jezusi
- Ne Besojmë

Zhvillimi i Karakterit

- Plani i Perëndisë—Zgjedhja Juaj
- Etikë e Biblës
- Martesa dhe Shtëpia
- I Krishteri në Bashkësinë e Tij

Zhvillimi i të Shërbyerit

- Kisha
- Çfarë Bëjnë Kishat
- Ungjillëzimi Personal
- Punëtorët e Krishterë
- Shërbesa e Mësimdhënies

Programi i Trainimit (Seritë mbi Shërbimin e Krishterë)

Çdo kishë ka nevojë për punëtorë të trainuar mirë që janë të aftë që të marrin përsipër detyrën e ndërtimit të trupit të Krishtit. 18 kurset e serisë mbi shërbimin e krishterë janë hartuar për të siguruar një themel solid për trainimin e punëtorëve për të shërbyer në kishën lokale.

Misioni dhe Ungjillizimi

- Fillimi i Kishave të Reja
- Ndarja e Lajmit të Mirë
- Kisha e Krishterë në Shërbesë

Aftësi të Shërbimit Praktik

- Predikimi dhe Mësimdhënia
- Njerëz, Detyra, dhe Synime
- Të Ndihmuarit e të Krishterëve për t'u Rritur
- Zgjidhja e Problemeve të Jetës

Zhvillimi Shpirtëror

- I Krishteri i Përgjegjshëm
- Jetesë e Begatshme
- Pjekuria e Krishterë
- Dhuntitë Shpirtërore
- Lutja dhe Adhurimi

Studime Biblike

- Tenda, Tempuj dhe Pallate
- I Gjallë në Krishtin
- Të Kuptuarit e Biblës
- Këshilltar, Mësues dhe Udhëheqës
- Mbretëria, Fuqia dhe Lavdia
- Gurë Themeli të së Vërtetës

Për më shumë informacion, dhe për të marrë një kopje të serisë së plotë prej 36 librash për kishën tuaj
Asembleja e Perëndisë, ju lutem kontaktoni Stephanie Plagenhoef.

stephanie.plagenhoef@agmd.org | 069-402-7476